



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional:
“Menaxhim dhe Marketing i Turizmit”
Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana GORICA
2. Prof As. Dr. Ermelinda KORDHA

Dhjetor/2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në
“Menaxhim dhe Marketing i Turizmit”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional: Menaxhim dhe Marketing i Turizmit
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 401, datë 12.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohe të plote
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 11 PAE/2PAK 2023-2024 18 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 30 studente 2023-2024 44 studente
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit Diplomë Profesionale “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” është në përputhje me legjislacionin në fuqi, VKM e KM Nr 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 të KM. Programi është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe ofron 120 ECTS. Programi realizohet me ndjekje me kohë të plotë, zgjat dy vite akademike dhe secili prej viteve realizohet me përmbushjen e 60 Krediteve (ETCS). UMSH shfrytëzon hapësirën e vet infrastrukturore dhe logjistike për të mundësuar një proces komod të mësimdhënies dhe mësimnxënies. UMSH ka gjithnjë përparësi që të sigurojë mjedise komode për stafin, studentët dhe të gjithë programet mësimore, sipas specifikave përkatëse. Në dispozicion të realizimit të veprimtarive të saj janë salla leksionesh, seminari, laboratore, biblioteka, salla qëndrimi, etj.

Programi i studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” kontribuon në formimin e profesionistëve të ardhshëm në një sektor ku promovohen, mbrohen e zhvillohen vlerat kulturore e kombëtare, siç është turizmi. UMSH dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike, një ndër fakultetet e para të tij, kanë eksperiencë rreth 15 vjeçare në realizimin me sukses të programeve të studimit të disa cikleve në fushat që i korrespondojnë programit të studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit”.

Programi profesional dy vjeçar në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit, me 120 ECTS, ofron një profil profesional që plotëson këto nevoja dhe që mund të vlerësohet e zhvillohet në çdo hap duke u bërë pjesë dhe marrë përgjegjësi në biznese e organizata të sektorit të turizmit. Ai synon të sigurojë formimin e studentit që në auditor, për t’u përshtatur lehtësisht dhe në kohë të shkurtër me tregun e punës.

Per ofrimin e ketij programi UMSH eshte bazuar ne disa strategji kombetare dhe ne tendencat afatgjate te zhvillimeve dhe sfidave te qeverise qendrore shqiptare. Pikerisht strategjia e 2019 2023 percaktoi se kush ishin nevojat per edukim, te profilit te njohurive dhe te kompetencave qe duhet te kishte akademia kundrejt tregut aktual te punes. Edhe eshte pikerisht ai element qe lidhet jo vetem me kompetencat teknike, por edhe te se drejtes dinamike, manaxhimit, akomodimit nga pikepamja shumedimensionale. Pra, ndertimi i ketij programi eshte mbeshtetur fort ne pikepamjen strukturore te sektorit dhe nevojtes per t ju pergjigjur me plotesim kompetencash. Rrjedhimisht nisur nga ana strukturore UMSH permes ketij programi studimi eshte munduar te kompletoje kuadrin.

Organizimi dhe mbikëqyrja e realizimit të programit bazohet në aktet rregullatore të institucionit (statut, rregullore e fakultetit, rregullore e departamentit, rregullore e programit të studimit), të cilat garantojnë mbarëvajtjen dhe realizimin me cilësi të tij. Nga ana tjetër, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ndërtuar një infrastrukturë aktive të bashkëpunimit me komunitetin e biznesit si dhe me institucionet publike apo organizatat profesionale. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH i shërbejnë institucionit në nivel fakulteti ose programi studimi, në veçanti për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në fushat konkrete të programeve që institucioni ofron.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka ndjekur të gjitha hapat, të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë ASCAL. Procedura filloi me diskutim midis ekspertëve pjesë e GVJ mbi standartet e cilësisë dhe kriteret që duhet të zbatohen në këtë proces. Cilësia e mëtejshme e punës së GVJ, u ndikua nga cilësia e dokumentacionit dhe diskutimet përgjatë agjendës në institucion në të gjitha takimet e zhvilluara. Një hallkë e rëndësishme për ecurinë e procesit ishte edhe instalimi i komunikimit të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe koordinatores teknike. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, dhe ndërtimit të agjendës për vizitën në institucion, realizimi i saj, në mënyrë sa më funksionale dhe me rigorozitet ka ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme. Tërësia e informacionit të mbledhur në institucion, duke u bashkuar me dokumentacionin përkatës ndikuan në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Takimet me Drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit, më pas me GVB, pedagogët e programit dhe studentët si edhe me zyrat përkatëse në nivel rektorati, ishin efektive në vijimësinë e procesit për të realizuar RVJ. Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky, u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB.

Universiteti Mesdhetar i Tiranës është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 2/60, datë 16.12.2024. Institucioni njofton në ASCAL më datë 19.12.2024, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 1855, datë 19.12.2024. *Komente mbi DRVJ e programit të studimit Diplome Profesionale në "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit". Duke mos patur komente, Drafti kalon në raport final*



Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në :
“MENAXHIM DHE MARKETING I TURIZMIT”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Për ofrimin e këtij programi UMSH është bazuar në disa strategji kombëtare dhe në tendencat afatgjatë të zhvillimeve dhe sfidave të qeverisë qendrore shqiptare. Pikërisht strategjia e 2019- 2023 përcaktoi se kush ishin nevojat për edukim, të profilit të njohurive dhe të kompetencave që duhet të kishte akademia kundrejt tregut aktual të punës. Edhe është pikërisht ai element që lidhet jo vetëm me kompetencat teknike, por edhe të së drejtës dinamike, manaxhimit, akomodimit nga pikëpamja shumë dimensionale.</p> <p>Pra, ndërtimi i këtij programi është mbështetur fort në pikëpamjen strukturore të sektorit dhe nevojës për t’iu përgjigjur me plotësim kompetencash. Rrjedhimisht nisur nga ana strukturore UMSH përmes këtij programi studimi është munduar të kompletojë kuadrin.</p> <p>Në të gjitha dokumentat strategjike që ka ndërtuar dhe zbaton institucioni, rezulton se programi i studimit jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare por synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, i shërben direkt sektorit specifik dhe në mënyrë direkte të gjithë ekonomisë shqiptare duke ndikuar fort edhe në rritjen dhe cilësinë mbarëkombëtare të mësimdhënies, kulturës dhe vlerave akademike kombëtare. Nenet përkatëse brenda statutit kanë identifikuar misionin dhe objektivat të cilat më tej shtjellohen edhe në dokumentat e tjerë të rëndësishëm.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit të UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DP MMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe</p>	<p>Diploma Profesionale në Menaxhim dhe Marketing Turizmi mbështetet jo vetëm në misionin dhe fushën e veprimtarisë së IAL-së, por vecanërisht në përputhje të plotë edhe me zhvillimet kombëtare dhe tendencat ndërkombëtare.</p>



<p>fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Mund të numërohen disa nga arsyet më kryesore pse ky program studimi ofrohet si shtesë në portofolin e vet të studimeve apo ofertës akademike në treg:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tendencat e ekonomisë shqiptare dhe ristrukturimi i saj; • Prioritizimi si sektori i shërbimeve nga njëra anë, ashtu edhe fokusi në sektorin e turizmit apo roli i turizmit në ekonominë shqiptare, dhe rrjedhimisht nevoja për mbështetje me dije dhe kapacitete edhe e këtij sektori; • Ky program studimi përbën një nevojë dhe plotësim për atë kategori nxënësish që nuk kanë mundur të hyjnë në DP sepse nuk kanë plotësuar kriteret bazë, duke iu krijuar mundësia për të zotëruar njohuritë dhe për të dhënë kontributet e tyre në sektorin më sfidues të vendit; • Për t'u pozicionuar në një treg dinamik si ai i turizmit. Turizmi përbën një ndër degët e shërbimit që vërteton më së miri faktin se ekonomia globale po shkon drejt një strukture të konsoliduar të sektorit të shërbimeve. • Statistikisht jo vetëm në vendin tonë, por edhe SHBA apo Europë, rreth 37% e të punësuarve i përkasin sektorit të shërbimeve. <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit të UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DP MMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim dhe Marketing Turizmi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të ofrojë dhe zgjerojë njohuritë në fushën e menaxhimit dhe marketingut, si dhe të nxisë dhe zhvillojë aftësi profesionale të studentëve në fushën e turizmit.</p> <p>Programi që ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut është në përputhje me qëllimet dhe misionin e UMSH të përmendura më sipër dhe të përcaktuara në dokumentet themelore të tij si Statuti, Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DP MMT, Plani strategjik i zhvillimit të UMSH, etj, si dhe me fushat e veprimit të tij, synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë mbi këtë sektor të ekonomisë. Eksiston një përputhje nga analiza e dokumentave strategjike në nivel institucional me ato të zbërthyer më tej në detaje në nivele fakulteti dhe departamenti, si njësi bazë që është përgjegjës për këtë program studimi.</p>

	<p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit të UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 5.1 Propozim per hapjen e programit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Programi i studimit të natyrës profesionale Diplomë Profesionale (DP) Menaxhim dhe Marketing i Turizmit është krijuar dhe zhvillohet për të përmbushur nevojat aktuale dhe dinamike të tregut për profesionistë të aftë në funksion të menaxhimit, marketimit, promovimit të turizmit vendas dhe të aktiviteteve të lidhura me të. Analiza e tregut e UMSH përbën një dokument sa analitik aq edhe strategjik i cili teksta bazohet në detajimin e analizës së tregut të punës që mbështet IAL me programe studimi, paralelizon me shifrat e numrit të studentëve të diplomuar sipas profileve duke e kthyer këtë analizë te tregut në një instrument që i pararend ofrimit të programeve të studimit apo rritjes së portofolit të UMSH në tregun shqiptar të ofertës akademike cilësore.</p> <p><i>Evidenca 6.1 Analizë e tregut të punës UMSH</i> <i>Evidenca 6.2 Analizë e tregut të punës për hapjen e programit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>E identifikuar si një pikë e fortë për programin, edhe nga dokumentat por edhe diskutimet me drejtuesin e departamentit dhe Dekanen e Fakultetit, ka rezultuar se UMSH ka një koherencë të gjatë në treg, dhe përbën një ndër IAL e hapura herët në tregun e arsimit të lartë me një experiencë shumëvjeçare të mëparshme. Kjo IAL teksta diversifikon ofertën akademike të vet, përmes cilësisë së këtij program rrit cilësinë e arsimit të lartë shqiptar dhe atij profesional, nxit sektorët e ekonomisë, ndjek dhe paraprin ristrukturimin e modelit të ekonomisë, zhvillon fort konkurrencën dhe pararend apo udhëheq të gjithë proces. Stafit është cilësor dhe i njohur në vend dhe vjen nga sektori.</p> <p><i>Evidenca 9. CV e stafit akademik të programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, neni 24.</i> <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DPMMT</i> https://www.umsh.edu.al/c/85/fakulteti-i-shkencave-ekonomike</p>

<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të përgjithshme, të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe i shërben misionit të tij.</p> <p>UMSH dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike, një ndër fakultetet e para të tij, kanë eksperiencë rreth 15 vjeçare në realizimin me sukses të programeve të studimit të disa cikleve në fushat që i korrespondojnë programit të studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit”.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DP MMT</i> <i>Evidenca 9 CV e stafit akademik të programit të studimit DP MMT</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, si një ndër njësitë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike. DMM është përgjegjës për këtë program studimi, si pjesë përbërëse e FSHE, ka kapacitete dhe ekspertizë në fushën e programeve që organizon, në vecanti të programit DP në MMT. Ofrimi i programit DP në MMT kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e misionit të institucionit në sektorin prioritar të turizmit dhe sektorët e lidhur me të, përmes përcjelljes tek studentët të dijeve të nevojshme teorike dhe praktike në fushat kryesore të tij (menaxhim dhe marketing).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, përgjegjës për këtë program studimi, si pjesë përbërëse e FSHE, ka kapacitete dhe ekspertizë në fushën e programeve që organizon, në vecanti të programit DPMMT. Prej shumë vitesh DMM organizon edhe programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi (me 5 profile, një nga të cilët është Menaxhim i Turizmit) dhe bashkëorganizon brenda FSHE programin DP në Shkenca Ekonomike (me 3 profile, një nga të cilët është Administrim</p>

<p>përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Biznesi). Të dhënat për personelin akademik efektiv dhe me kontratë (Tabelat dhe CV e stafit akademik) dhe plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkates pasqyrojnë këtë kapacitet. FSHE aktualisht ka në përbërjen e tij tre departamente, ku angazhohet personel akademik efektiv dhe me kontratë (Tabela 1), me përvojë akademike dhe aplikative, kapacitete të cilat përbëjnë burimet e nevojshme dhe të duhura dhe njëkohësisht bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të Fakultetit.</p> <p>Çdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit respektivë. Bazuar në Legjislacionin në fuqi si dhe në të gjitha aktet rregullatore të UMSH, institucioni ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, manaxhimit të marrëdhënieve me studentët, të marrëdhënieve me jashtë, të kërkimit shkencor, të gjitha këto njësi, pjesë organike të UMSH mbështesin direkt në përditshmërinë e tyre cdo hallkë, që nga mësimdhënia apo realizimin dhe efciensën e marrëshjeve të bashkëpunimit. Është lehtësisht e dukshme si nga vizita në institucion, takimet e qeta dhe të rrjedhshme me stafet dhe njesitë drejtuese, apo dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për vlerësim, se UMSH ka krijuar një sistem eficient dhe të qartë të veprimit dhe ndërveprimit të njësi dhe aktorëve të tij të brendshëm në funksion të sigurimit të cilësisë ofrimit të këtij program studimi.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 9. CV e stafit akademik të programit të studimit DPMMT</i> https://www.umsh.edu.al/c/85/fakulteti-i-shkencave-ekonomike</p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Departamenti të Menaxhimit dhe Marketingut</i> <i>Evidenca 12.1 Plani mësimor DPMMT në hapje të programit</i> <i>Evidenca 12.2 Plani mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Procesverbal mbledhje departamenti për syllabuset 2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor</p>	<p>Një ndër avantazhet e këtij programi është se studentët që u regjistruan për herë të parë në këtë program të studimit, të cilët</p>



<p>e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>tashmë janë diplomuar, vinin direkt nga tregu i punës. Kjo në një farë mënyre përbënte testin se sa i përkonte apo përshtatej ky program nevojës së tyre për njohuri dhe kompetenca praktike të tregut të punës, i hapur në vitin 2022 për herë të parë, sot në vitin e tretë të tij janë regjistruar 60 studentë duke kaluar kuotat aktuale. Duke patur në grupin e parë të studentëve të regjistruar në vitin 2022 vit në të cilin sapo startoi ky program studimi, mbi 40% që vinin nga tregu i punës përmes bizneseve të tyre ose të qënurit të punësuar në këtë treg përbënte edhe një sfidë sepse ishte një vit i përballjes së asaj cka kishte krijuar njësia bazë dhe asaj cka po testohej tashmë në treg.</p> <p><i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> https://www.umsh.edu.al/d/458/praktikat-profesionale-studentet-e-umsh-vizitojne-operatoret-turistike https://www.umsh.edu.al/d/321/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-marreveshje-bashkepunimi-me-shoqaten-bashkimi-i-prodhuesve-shqiptare</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Për të plotësuar qasjen dhe përforcuar bindjen e përputhjes me tregun e punës, po në vitin e parë të ofrimit të këtij programi janë organizuar edhe workshop me operatorët më kryesorë në sektorin e akomodimit. Formate të tilla të workshopeve janë organizuar brenda mjediseve dhe laboratorëve të UMSH. Përfaqësuesit e 4 hoteleve më të mëdha por edhe ofrues të tjerë të akomodimit nga qytete të ndryshme të vendit patën një qasje ndëraktive me studentët, ku këta të fundit patën oferta konkrete të punësimit të tyre.</p> <p>Këto aktmarreveshje janë nënshkruar në kuadër të praktikës profesionale të studentëve, mundësive së punësimit dhe zhvillimit të veprimtarive të interesit reciprok.</p> <p>Në këto lidhje krijohen baza të shëndosha për bashkëpunime në fushën e menaxhimit të bizneseve, projekte në lidhje me procesin akademik-mësimor, organizimin e konferencave të përbashkëta, orëve të hapura, tryezave të rumbullaketa, vënie në dispozicion të ambjentëve/ mjeteve mësimore e laboratorike për zhvillim orësh mësimore, akses në bibliotekë dhe punë kërkimore.</p> <p><i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> https://www.umsh.edu.al/d/458/praktikat-profesionale-studentet-</p>

	<p>e-umsh-vizitojne-operatoret-turistike https://www.umsh.edu.al/d/321/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-marreveshje-bashkepunimi-me-shoqaten-bashkimi-i-prodhuesve-shqiptare</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit profesional është në përshtatje të plotë me strategjinë e zhvillimit të Institucionit, që i shërben nxitjes së sektorëve strategjikë të ekonomisë shqiptare dhe zhvillimit të qëndrueshëm të saj. Njëkohësisht, për të mbuluar nevojat e këtij programi të ri studimi, UMSH mbështetet në kapacitetet ekzistuese akademike, infrastrukturore dhe në një përvojë të gjerë akademike e profesionale, që garanton zbatimin e programit duke realizuar optimalisht objektivat e tij.</p> <p>Data base lehtësisht i aksesueshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit nuk është thjesht një listë e institucioneve publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat ndërvepron UMSH për të mbështetur dhe ofruar një product cilësor përmes kësaj diplome profesionale. E transmetuar edhe nga vizita në institucion, me të gjithë aktorët, por edhe e përcjellë nga studentët, reflektohet qartë dhe është e dukshme prania e aktorëve të tretë në mbështetje të këtij program studimi. E transmetuar edhe nga diskutimi në UMSH. ky program studimi është në ciklin e parë të tij, dhe vlerësimi i bashkëpunimeve me institucione e organizata në funksion të këtij programi do të bëhet në periudhat e ardhshme.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmartjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>UMSH ka realizuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë, brenda e jashtë vendit, si shtetërore e shoqëri private, për të zhvilluar veprimtari e aktivitete të ndryshme kërkimore, shkencore, promovuese dhe kualifikuese si dhe për realizimin e praktikave dhe mundësinë e punësimit të studentëve për gjithë programet e studimit në tërësi dhe në veçanti edhe për programin e studimit “Menaxhim dhe Marketingu i Turizmit”.</p> <p>Aktmarrëveshjet e përbashkëta të UMSH kanë qënë shumë efikase dhe kanë ndikuar në zhvillimin e veprimtrive të ndryshme, në dobi të programit. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSZ) është njësi që merret me orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë ciklit të studimeve dhe në drejtim të punësimit të tyre. Në bashkëpunim me departamentet dhe njësitë e tjera, ofron këshillim të karrierës për studentët dhe zhvillon aktivitete trajnuese.</p>
<p>Konkluzione</p>	


	<i>Institucioni arsimit të lartë UMSH në përmbushje të ofrimit të këtij programi studimi ka bërë përpjekje eficiente për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi. Departamenti dhe njësia kryesore por edhe strukturat e tjera të përfshira në përmbushjen e objektivave të këtij program studimi prodhojnë raporte për të analizuar efciensën e marrëveshjeve të realizuara në mbështetje të këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Sipas parashikimeve ligjore, UMSH ka ngritur dhe bërë funksionale zyrat përkatëse për sigurimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së mësimdhënies dhe që garanton të gjithë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. E bazuar në dokumentacionin mbështetës por edhe përgjatë diskutimeve në institucion me drejtuesin e kësaj njësie rezultojnë se kjo njësi ka një vëmendje të duhur dhe tepër të vecantë nga strukturat drejtuese, e cila bën eficient dhe transparent procesin, përfshin të gjithë aktorët, transmeton informacionin tek drejtuesit, bën kontrollet periodike, dhe sigurohet për mbarëvajtjen e çdo etape.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit.</p> <p>Bazuar në Legjislacionin në fuqi si dhe në të gjitha aktet rregullatore të UMSH, institucioni ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Struktura kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë është NJSBCZHK vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative të UMSH. Ajo ka akses</p>

<p>n</p> <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>në të gjitha të dhënat e institucionit. Veprimtaria e NJSBCZHK është e rregulluar sipas Rregullores së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) e cila është bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Date 22.07.2015; Neni 103 dhe 104. •Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë; dhe në rregulloren e UMSH. <p>Përgjatë takimit në institucion, por edhe nga diskutimet me këtë njësi u identifikua se:</p> <p>Kjo njësi nuk mjaftohet vetëm me ndarjen e pyetësorëve tek studentët për të vjelë mendimin e tyre kritik, por bëjnë edhe monitorimet dhe vlerësimet e stafit, përfshihen në mësimdhënie për të parë metodikën që përdor pedagogu. Përdorin formular të vecantë e cila plotëson dhe garanton dhe qëllimin e kësaj njesie, sikurse edhe për përgjegjësinë për aspektin e didaktikës dhe metodikes që përdor pedagogu.</p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH;</i> <i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 18. Urdhër i Rektorit të UMSH Nr. 1 datë 27/02/2024 për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB)</i> https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>Zyra e sigurimit të cilësisë funksionon me një planifikim të kalendarit të punës, që miratohet fillimisht nga rektorati. Ka në vëmendje monitorimet për të parë se si është ecuria e procesit mësimor. Kjo njësi procedon mbi bazën e vendimeve të rektoratit dhe komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë, ndërkohë që kujdeset që raportet të jenë në shërbim të departamenteve dhe të jenë të firmosura nga të paktën 2 persona. NJSBCZHK ka ngritur nje folder me të gjitha dokumentat që mban institucioni. Furnizon edhe faqen e web, madje kanë një rubrikë të vecantë ku bëhet publike raportet vjetore në faqen e web (kjo njësi ka rubrikën e vet brenda faqes së web të UMSH). Realizimi i fokus grupeve që zhvillohet cdo fund semestri perbën një proces që i bashkangjitet dhe procesit të ndarjes së pyetësorëve të studentëve cdo fund semestri. Kjo bëhet në javën e 13 ose 14 për cdo semestër. Përdorimi i një metodologjie mikse që ndërthur pyetësorin me diskutimet live perbën një instrument cilësor që përdor UMSH në këtë etapë kaq të rëndësishme. Përdoret një metodologji e pyetjeve të miraturara parakrisht nga rektorati. Në fund, të dhënat e përpunuara i</p>



	<p>kalohen në formë raporti rektoratit. Në fund të cdo viti akademik bëhet dorëzimi i dosjes shoqëruar me raportin përmbledhës që është publik. Nga diskutimet me drejtuesin dhe stafin e kesaj njësie synohet që nuk është qëllimi të gjenden gabime por të shihet nëse janë reflektuar të gjitha formatet e provimeve apo të detyrave të kursit. Pra, formatet të jenë të unifikuara, dhe ky proces të kryhet në mënyrë të njëjtë.</p> <p>Gjithashtu, NJSBCZHK bën dhe 2 takime në muaj me këshillin studentor, sipas një kalendari të shpallur, për gjëra që mund të kenë studentët dhe kjo njësi i përcjell në rektorat. Vihet re një lloj besimi të studentëve ndaj kësaj njësie. Por edhe që në focus grupet studentët shprehen lirshëm. P.sh., atje është pyetja se cilët janë 5 emra të 5 pedagogëve më të mirë. Mundohet të vilet informacioni përmes kësaj metodologjie që ka rezultuar cilësore.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf</p>
--	---

Konkluzione	<p><i>UMSH përdor tregues të qartë për matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe pasqyrimin e gjendjes së gjithë aktivitetit akademik vjetor. Vlerësimet kryhen sipas akteve rregullatore (monitorime, udhëzime, formate, etj).</i></p> <p><i>Cilësia konsiderohet si një çështje e të gjitha njësive dhe strukturave institucionale. Rrjedhimisht institucioni i jep vend shumë të rëndësishëm tërheqjes së mendimit të studentëve si dhe ekspertëve të jashtëm me të cilët UMSH bashkëpunon.</i></p>
--------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit", ofron dije të qëndrueshme dhe të krahasueshme me ato të sistemit arsimor Europian, përmes të cilave transmetohen njohuri në disiplinat shkencore e profesionale për përgatitjen e specialistëve të rinj, të aftë që t'i shërbejnë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë. Programi profesional dy vjecar në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit, me 120 ECTS, ofron një profil profesional që plotëson këto nevoja dhe që mund të vlerësohet e zhvillohet në çdo hap duke u bërë pjesë dhe marrë përgjegjësi në biznese e organizata të sektorit të turizmit.</p> <p>Si nivel studimi, ky program mban numrin 5 të kornizës europiane (dhe shqiptare) të kualifikimit. Struktura e planit mësimor dhe përmbajtja konkrete e lëndëve në përbërje të programit të studimit garanton njohuri aftësi dhe kompetenca që i takojnë nivelit 5 të AQF (Albanian Qualification Framework).</p> <p>Fusha kërkimore e programit të studimit Diplomë Profesionale (DP) "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit" është në përputhje të plotë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</p> <p><i>Evidenca 5.2 Urdhër Nr. 401 dt. 12.7.2022 "Për hapjen e programi të studimit DPMMT"</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i></p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 9 CV e stafit akademik të programit të studimit DP MMT</i></p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DP MMT</i></p> <p><i>Evidenca 12.2. Plani Mësimor DPMMT 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të</p>	<p>Për ofrimin e këtij programi UMSH është bazuar në disa strategji kombëtare dhe në tendencat afatgjatë të zhvillimeve dhe sfidave të qeverisë qëndrore shqiptare. Pikërisht strategjia e 2019 2023 përcaktoi se kush ishin nevojat për edukim, të profilit të njohurive dhe të kompetencave që duhet të kishte akademia kundrejt tregut aktual të punës. Edhe është pikërisht ai element që lidhet jo vetëm me kompetencat teknike, por edhe të manaxhimit, akomodimit nga pikepamja shumëdimensionale.</p>

<p>teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Pra ndërtimi i këtij programi është mbështetur fort në pikëpamjen strukturore të sektorit dhe nevojës për t'u përgjigjur me plotësim kompetencash. Rrjedhimisht nisur nga ana strukturore UMSH përmes këtij programi studimi është munduar të kompletojë kuadrin.</p> <p>Bazuar në këtë filozofi është krijuar një portofol i njohurive përmes lëndëve që janë përfshirë duke integruar ato të ekonomisë me turizmin, gjuhët e huaja, me njohjen e financës, të manaxhimit të marketingut, pra jo vetëm disenjimi i profileve që lidhen me thjesht kuadrin ekonomik, por më tej në një ndërfaqje apo sens ndërdisiplinor të kuadrit.</p> <p>Ndërqsja dhe prioritizimi i sektorit të turizmit, mungesat e ofertës akademike, nevoja për të diversifikuar portofolin e shërbimeve akademike në tregun shqiptar e nxiten gradualisht dhe u kthyen në një sfidë për stafin dhe drejtimin e UMSH. Krijimi i një portofoli të njohurive shumë të diversifikuar nëpërmjet edhe lëndëve me zgjedhjeve, studentëve u krijohet mundësia e gjykimit të tij të përzgjedhjes se ku të fokusojë përpjekjet më tej.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 10. Rregulloret e programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit të natyrës profesionale Diplomë Profesionale (DP) Menaxhim dhe Marketing i Turizmit është krijuar dhe zhvillohet për të përmbushur nevojat aktuale dhe dinamike të tregut për profesionistë të aftë në funksion të menaxhimit, marketimit, promovimit të turizmit vendas dhe të aktivitetëve të lidhura me të.</p> <p>Me qëllim që të sigurohet optimizimi i dijeve dhe rrjedhimisht i njohurive përmes këtij program studimi u sugjeruan dhe dakortësua me stafin dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore përfshirja e lëndëve që lidhen me njohuritë e tendencave të turizmit sic është turizmi i qëndrueshëm.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke</p>	<p>Programi i studimit DPMMT përmban lëndë bazë të programit (formim i përgjithshëm, përgatitje metodologjike, kulturë e përgjithshme) (A) gjithsej 12 ECTS; Lëndë karakterizuese (formim specifik sipas programit) (B) gjithsej 66 ECTS; Lëndë</p>



<p>përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>ndërdisiplinore ose/dhe integruese dhe lëndë me zgjedhje (C) gjithsej 18 ECTS; Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, informatikë, praktika) (D) gjithsej 18 ECTS. Gjithashtu, në planin mësimor për programin e studimit Diplomë Profesionale (DP) “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” gjenden të pasqyruara vecas edhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe Detyrime përmbyllëse (provim përfundimtar) (E) gjithsej 6 ECTS, me të cilat përfundon cikli i studimit dhe mundësohet diplomimi i studentit.</p> <p><i>Evidenca 12.1 Plani mësimor DPMMT në hapje të programit</i> <i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në njohuritë kryesore që ofron, Programi DPMMT merr kodin 0413 (Menaxhim dhe administrim). UMSH ka përcaktuar dhe ka përcjellë pranë MAS kodet e programeve të studimit që organizohen nga institucioni, referuar VKM 310, dt. 11.05.2022 “Mbi Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në Vendimin Nr. 288, Datë 11.5.2022 “Për Miratimin e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (Isced 2011), të Fushave të Arsimit dhe të trajnimit të Ksna 2013 (Ksna-F 2013) dhe të përshkrimeve të tyre të detajuara” si edhe në Udhëzimin Nr.31, Datë 15.11.2022 “Për Procedurat Për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”. Pas miratimit të tyre do të vijohet më tej me kodifikimin respektiv të lëndëve për</p>



	çdo program studimi që organizohet në Institucion.			
Konkluzione	<p><i>Programi i Studimit Diplomë Profesionale “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në planin mësimor të programit të studimit Diplomë Profesionale “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” gjenden të pasqyruara elementët në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si emërtimi i lëndës/modulit, semestri kur zhvillohet lënda, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime dhe seanca të praktikave të zhvilluara jashtë auditorit, raporti leksion/seminar, ushtrime, praktika mësimore, mënyra e kontrollit të dijeve me provim si dhe totali i krediteve prej 120 ECTS.</i></p> <p><i>Duke synuar t’iu përgjigjet nevojave të tregut të punës kryesisht në Shqipëri, por në perspektivë edhe në rajon e më gjerë, ky program ofron kompetenca dhe nxit zhvillimin e aftësive të nevojshme dhe të dobishme për t’u përshtatur më lehtësisht me kërkesat në tregun e punës</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Ky program studimi është hapur bazuar në Urdhërin e MAS nr.401, datë 12/07/2022 dhe ka filluar zbatimin në vitin akademik 2022-2023.</p> <p>Programi organizohet nën drejtimin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike, si njësi që zhvillon dhe bashkërendon aktivitetin mësimor e kërkimor në disiplinat e fushës së menaxhimit dhe marketingut në Universitetin “Mesdhetar i Shqipërisë”.</p> <p>Stafet akademike që japin lëndë dhe module në këtë program studimi kanë një jetëgjatësi të konsiderueshme në këtë IAL, gjë e cila reflekton cilësinë e lartë të mësimdhënies, komunikimin dhe krijimin e kushteve konforte për stafin, gjë e cila ka bërë që jo vetëm të mos largohet sikurse rëndom ndodh në ditët e sotme</p>

apo IAL të tjera, por të investojnë dhe përfshihen shumë më tepër personalisht në mbarëvajtjen e cilësisë së UMSH. Numri stafit akademik të departamentit, sipas kategorive të titujve dhe gradave, si dhe sipas ndarjes në staf efektiv (PAE) dhe staf me kontratë (PAK) jepet në tabelën e mëposhtme.

Stafi akademik sipas titujve/gradave	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	1	1	1
Prof. Asoc. Dr.	3	1	2	1
Dr.	3	1	4	1
Dr. në proces	0	0	0	0
Msc.	5	1	4	1
Total	12	4	11	4

Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike

Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut

Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DP MMT

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, përgjegjës për këtë program studimi, si pjesë përbërëse e FSHE, ka kapacitete dhe ekspertizë në fushën e programeve që organizon, në vecanti të programit DPMMT. Prej shumë vitesh DMM organizon edhe programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi (me 5 profile, një nga të cilët është Menaxhim i Turizmit) dhe bashkëorganizon brenda FSHE programin DP në Shkenca Ekonomike (me 3 profile, një nga të cilët është Administrim Biznesi). Natyra e programit nuk kërkon aplikimin e praktikave laboratorike e klinike.

Personeli ndihmës mësimor-akademik dhe ai administrativ kryen veprimtari mbështetëse për procesin mësimor, për studentët dhe detyra administrative. Ai luan rol të vecantë në sigurimin e përdorimit pa ndërprerje dhe problematika të të gjithë laboratorëve që institucioni ka ngritur dhe ve në dispozicion të programeve, përfshirë edhe DPMMT.

Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike

	<p>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut</p> <p>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DP MMT</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, si njësi përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e programit, garanton ecurinë e procesit mësimor, mbikëqyr personelin akademik, monitoron cilësinë e hartimit të syllabuseve dhe zbatimin e tyre përgjatë procesit të mësimdhënies në programin e studimit.</p> <p>Koordinatori është një anëtar nga personeli akademik i fakultetit dhe ushtron funksionin e tij në bashkëpunim me njësitë bazë dhe atë kryesore, në lidhje me procesin mësimor dhe aspekte menaxheriale të punës.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut përgjegjës për programin e studimit DPMMT, organizohet në grupe mësimore-kërkimore. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplinat e menaxhimit, marketingut, dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike si njësi kryesore dhe Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit DPMMT, plotësojnë dhe tejkalojnë kriterin ligjor të përbërjes sipas numrit dhe gradave. DMM ka në përbërjen e tij personel akademik me kohë të plotë me grada dhe tituj, angazhon në procesin mësimor dhe të kërkimit edhe punonjës me kontratë, të kategorisë profesor, të kategorisë Dr. dhe në proces të studimeve doktrale duke përfituar nga ekspertiza shkencore dhe përvoja akademike e tyre, përfshin dhe staf jo akademik, sikurse përcakton dhe kordinatorin e programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Ky program profesional në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit ka për qëllim të formojë specialistë në fushat ku evidentohen qartë nevojat sipas kërkesave të tregut të punës dhe të kontribuojë për të përballuar sfidat aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit në veçanti dhe rajonit në tërësi. Elemente si plani mësimor, programi për çdo lëndë (Syllabuset), rregullorja e programit të studimit, stafi i angazhuar për realizimin e programit të studimit, strategjia e zhvillimit të programit të studimit Diplomë Profesionale (DP) “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit”, të depozituara në departament dhe bashkëngjitur këtij raporti janë disa nga momentet që reflektojnë se si njësia bazë ashtu edhe ajo kryesore përgjegjëse për programin e studimit mbartin të gjithë informacionin dhe strukturën.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DP MMT</i> <i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale (DP) “Menaxhim dhe Marketing i Turizmit” është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Ky program përfshihet në fushën 4 – Biznes, administrim dhe ligj në klasifikimin e fushave të arsimit sipas ISCED-F 2013, klasifikim i cili është deklaruar nga institucioni në MAS në korrik 2023. Modulet, kreditet, ndarjet në semestra janë të organizuara qartë dhe saktë, dhe reflektuara jo vetëm në planin mësimor por të gjithë setin e tabelave të vëna në dispozicion.</p> <p><i>Evidenca 12.1 Plani mësimor DPMMT në hapje të programit</i> <i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024</i> <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programin e studimit DPMMT mund ta ndjekin nxënës që vërtetojnë përfundimin e Maturës Shtetërore si dhe ata të cilët zotërojnë një diplomë tjetër studimi të shkollës së mesme të njohur dhe të ekuivalentuar sipas legjislacionit në fuqi. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH dhe ka gjetur zbatim në këtë program studimi gjatë vitit në vazhdim.</p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p>

	<p>https://www.umsh.edu.al/c/231/broshura-informuese https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6wmo4Qp-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdZg1E1CaSfeOKQ/viewform</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, por edhe vecanërisht nga diskutimet me stafin e brendshëm dhe të jashtëm për këtë program studimi rezultojnë se stafi bën një përpjekje të vazhduar dhe është në kërkim të përmirësimit të programit të studimit, dhe rrjedhimisht të syllabuseve, apo të përfshirjes më shumë të literaturave të reja të kohëve të fundit, apo të përgatitura nga vetë stafi, apo të referuara të studiesve dhe kërkuesve më në zë të fushës në vendin tonë.</p> <p>Stafi diskuton se sektori i turizmit është mjaft dinamik dhe kërkimi për literaturë cilësore kërkon kohë dhe impenjim, gjë të cilën ky staf e ka mjaft të integruar.</p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Stafi shpreh se kërkon ta përmirësojë këtë program studimi sa më shumë, jo vetëm me literaturë dhe eksperiencë por edhe qasjen praktike që një pjesë e stafit tashmë e ka. Ata shprehin se marrëveshjet do të shtohen, intershipet do të shtohen, dhe janë të vetëdijshëm se procesi i përmirësimit është i paevitueshëm, që kërkon kohë, dhe vecanërisht impenjim, që stafi e ka dhe synon.</p> <p>Për programin DPMMT, që zhvillohet për herë të parë, në këtë vit akademik nuk janë bërë ndryshime në syllabuse. Pritet të përmbyllet procesi i akreditimit dhe stafi të përfshihet në përmirësim. Megjithatë edhe nga takimi me stafin apo përmbyllja me drejtuesin e njësisë bazë dhe kryesore u dakortësua mbi nevojën e përmirësimit të syllabuseve dhe garantimin e uniformitetit të elementëve brenda tyre, rifreskimit të literaturës së përdorur, të përputhjes së literaturës me titullin e modulit, të përdorimit të literaturës së autorëve më në zë në vendin tonë, të nevojës së diskutimit të termave të syllabuseve të lëndëve midis stafit për të eliminuar përplasjet, të nevojës për të përfshirë edhe lëndë të turizmit të qëndrueshëm.</p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin e programit</i></p>
<p><i>Konkluzione</i></p>	<p><i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.</i> <i>Në planin mësimor të programit të studimit Diplomë Profesionale</i></p>

	<p><i>"Menaxhim dhe Marketing i Turizmit"</i> gjenden të pasqyruara elementët në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si emërtimi i lëndës/modulit, semestri kur zhvillohet lënda, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime dhe seanca të praktikave të zhvilluara jashtë auditorit, raporti leksion/seminar, ushtrime, praktika mësimore, mënyra e kontrollit të dijeve me provim si dhe totali i krediteve prej 120 ECTS. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH dhe ka gjetur zbatim në këtë program studimi gjatë vitit në vazhdim.</p> <p><i>Përmiresimet e rekomanduara për një të ardhme në afatin e mesëm duhet të fousohen në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Shmangiet e mbivendosjeve të disa temave në syllabuse</i> • <i>Përditësimin e literaturës dhe shtimi i literaturës në gjuhën shqipe</i> • <i>Reflektimi i ndryshimeve të tregut duke përfshirë lëndë me zgjedhje të fushës. Sugjerohet shtimi i lëndes turizmi i qendrueshem</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Aftësitë profesionale të studentëve të këtij programi janë të garantuara përmes një shpërndarjeje cilësore të moduleve, krediteve dhe orëve mësimore brenda tyre, të cilësisë së stafit dhe marëveshjeve të bashkëpunimit, të tendencës për përmirësim me qasjet nga praktika dhe teknologjia. Të përcaktuara si pika kyce dhe pikat të forta të këtij programi studimi, këto elemente teksa synohen të përmirësohen në të ardhmen, rezultojnë të tërheqin edhe elementë të tjerë me vete. Plani mësimor që përmbledh të gjithë shpërndarjen e lëndëve dhe të praktikave së bashku me detajimet e lëndëve edhe përmes syllabuseve të tyre kanë rezultuar se lëndët dhe shpërndarja e</p>

	<p>tyre mundësojnë shpërndarjen dhe thellimin e njohurive apo të aftësive bazë të studentëve.</p> <p>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024 Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Objektivat formues për programin e studimit DPMMT dhe rezultatet e pritshme të nxënurit mundësohen nga shpërndarja e lëndëve/moduleve në të katër semestrat pasi kalohet natyrshëm nga formimi i përgjithshëm në formimin karakterizues, shoqëruar me lëndët integruese e plotësuese.</p> <p>Megjithatë këto objektiva do të përforcohen me plotësimin e sugjerimit të përfshirjes së një lënde të paktën që lidhet me turizmin e qëndrueshëm, sugjerohet Manaxhimi i Turizmit të Qëndrueshëm. Apo edhe përfshirja e lëndëve të turizmit në shportën e lëndëve me zgjedhje.</p> <p>Nje element garantues është se ka 1 lende per nensektor te turizmit, p.sh., menaxhimi i njësive akomoduese, i tur-operatorëve, apo sistemet informatike të dedikuara për turizmin. Formimi i studentëve përforcohet me realizimin e praktikës dhe përmbillet me provimin përfundimtar të formimit, që vlerëson tërësinë e njohurive të përfituara gjatë ciklit të studimit.</p> <p>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024 Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Bazuar në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të KM, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike.</p> <p>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024 Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024 Evidenca 16. Lista e projekteve Kombëtare, Nderkombëtare UMSH</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik</p>	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim dhe Marketing Turizmi" ka një ndërthurje dhe kombinim të lëndëve që zhvillohen në të katër semestrat, duke i përshtatur si me njohuritë që studentët duhet të marrin për këtë program studimi edhe me kërkesat</p>


<p>mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>konkrete të tregut, në mënyrë që studentët të mund të fillojnë një karrierë profesionale të suksesshme.</p> <p><i>Evideca 2 Plani strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 3 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DP MMT</i> <i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Sikurse është thënë edhe më lart, e përmbledhur në këtë seksion mund të thuhet ajo cka është identifikuar nga dokumentacioni, diskutuar me stafet dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore, dhe e dakortësuar në fund të procesit të vizites në institucion. Kështu, syllabuset duhet të jenë në përmirësim të vazhduar, pasi jo vetëm për dinamikën e sektorit por ka vend për përputhje të emërimit të lëndën me tekstin e literaturës së përdorur, të selektimit të autorëve më të mirë të sektorit të turizmit si referenca, të përfshirjes së sa më shumë literaturë cilësore të viteve të fundit në gjuhën shqip.</p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Praktikat profesionale zhvillohen në bashkëpunim me institucione me të cilat Universiteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në përmbushje të objektivave të programit të studimit.</p> <p>Nga takimi me zyrën e marrëdhënieve me jashtë dhe dokumentacioni shoqëruar rezulton se marrëveshjet e bashkëpunimit me jashtë mundësojnë dhe japin mundësi stafit të këtij program sikurse edhe studentëve që të përfitojnë dukshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga këto marrëveshje.</p> <p><i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH</i> <i>Evidenca 19.1 Vendim për miratimin e Bordit të tregut të punës</i> <i>Evidenca 19.2 Rinovim i Bordit të tregut të punës 12.2022</i> <i>Evidenca 20. Takim me Bordin e tregut të punës</i> https://www.facebook.com/share/p/këCotaUrBaNzf3So/?mibextid=oFDknk</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Hartimi i programit të studimit DPMMT është mbështetur në bashkëpunimin me partnerët nga biznesi dhe përvojën akademike në aspektin e përcaktimit të masës së nevojshme të elementëve praktikë në program. Ky program garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve</p> <p><i>Evidenca 6.1 Analizë e tregut të punës UMSH</i> <i>Evidenca 6.2 Analizë e tregut të punës për hapjen e programit DPMMT</i></p>

Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim dhe Marketing Turizmi” ka një ndërthurje dhe kombinim të lëndëve që zhvillohen në të katër semestrat, duke i përshtatur si me njohuritë që studentët duhet të marrin për këtë program studimi edhe me kërkesat konkrete të tregut, në mënyrë që studentët të mund të fillojnë një karrierë profesionale të suksesshme.</i></p> <p><i>Arritja e objektivave formues për programin e studimit DPMMT mundësohet nga shpërndarja e lëndëve/ moduleve në të kater semestrat në mënyrë të tillë që të kalohet natyrshëm nga formimi i përgjithshëm në formimin karakterizues, shoqëruar me lëndët integruese e plotësuese.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>UMSH ka realizuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë, brenda e jashtë vendit, si shtetërore e shoqëri private, për të zhvilluar veprimtari e aktivitete të ndryshme kërkimore, shkencore, promovuese dhe kualifikuese si dhe për realizimin e praktikave dhe mundësinë e punësimit të studentëve për gjithë programet e studimit në tërësi dhe në veçanti edhe për programin e studimit aktual. Njohuritë e natyrës teorike dhe kombinimi me aftësimin praktik në këtë program u japin studentëve kompetenca, aftësi profesionale dhe personale që përshtaten me kërkesat e pozicioneve të punës në profile menaxhimi, marketingu, logjistike, operacionesh, që kërkohen nga tregu i punës aktualisht dhe në periudhë afatmesme.</p> <p><i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH</i> <i>Evidenca 19.1 Vendim Bordi i tregut te punes</i> <i>Evidenca 19.2 Rinovim i Bordit te tregut te punes 12.2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet</p>	<p>UMSH ka përfshirë dhe terhqur ne kete program studimi bizneset duke i ftuar ne formen e workshopeve me qellim qe ky process te perfshije edhe studentet dhe stafet, ka përfshirë aktore te tjere publike dhe private duke i bere pjese te ketij program</p>



<p>vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>studimi.</p> <p><i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH</i> <i>Evidenca 19.1 Vendim Bordi i tregut te punes</i> <i>Evidenca 19.2 Rinovim i Bordit te tregut te punes 12.2022</i> <i>Evidenca 20. Takim me Bordin e tregut te punes</i> <i>Evidenca 21. Anëtarët e ZKSK viti akademik 2023-2024</i></p> <p>https://www.facebook.com/share/p/kwCotaUrBaNzf3So/?mibextid=oFDknk</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Dijet e ofruara në këtë program studimi përmbajnë elementët e domosdoshëm për një edukim cilësor dhe aftësim profesional dhe përcjellja e tyre te studentët bëhet duke kombinuar trajtimin teorik të shoqëruar me elementë të aplikimit në situata praktike në lëndët e formimit të përgjithshëm brenda auditorit, ndërsa në lëndët e specialitetit ky kombinim bëhet brenda dhe jashtë auditorit, përfshirë edhe praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH</i> <i>Evidenca 14.2 Procesverbal mbledhje departamenti 06.2023</i> <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit DPMMT</i></p> <p>https://www.facebook.com/share/p/kwCotaUrBaNzf3So/?mibextid=oFDknk</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar UMSH të mbajë kontakte dhe të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca, profesione dhe vende pune që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here.</i></p> <p><i>UMSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të pushtetit qendror e lokal, biznese e shoqata profesionistësh dhe organizon takime e aktivitete që mundësojnë informimin mbi të rejat më të fundit dhe marrjen e propozimeve për përditësim në programet e studimit që institucioni organizon. Anëtarë të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie në program janë pjesë e rrjeteve profesionale të sektorit, duke shtuar mundësitë për komunikim të vazhdueshëm në funksion përmirësimit dhe përcjelljes së praktikave të mira për programin.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>UMSH duke ofruar këtë program studimi ofron të gjitha kushtet që të ushtrohet veprimtaria në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Metodët dhe programet e ofruara janë në përputhje me standardet kombëtare dhe është bazuar dhe në eksperiencat më të mira ndërkombëtare, për të cilat stafi akademik është formuar dhe trainuar.</p> <p>Format e mësimi teorik dhe praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat mësimore dhe profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit etj. Në përfundim të secilit modul parashikohet zhvillimi i provimit përkatës. Në total për këtë program studimi, për të dy vitet e studimit, orët në auditor janë: Leksione = 516 orë dhe Seminare = 465 orë dhe Laboratore = 45 orë mësimore në auditor.</p> <p>Në programin mësimor përfshihen të gjitha format e parashikuara brenda këtij kriteri dhe departamenti përgjegjës kujdeset për ofrimin cilësor të tyre, duke përfshirë gjithashtu orët e hapura me lektorë nga industria.</p> <p><i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca: Vizita në institucion. Takimi me pedagogët e programit. Takimi me studentët e programit te studimit</i> https://www.umsh.edu.al/d/458/praktikat-profesionale-studentet-e-unish-vizitojne-operatore-turistike</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik është i gatshëm të adaptojë metoda të reja në mësimdhënie për t'iu përshtatur diversitetit dhe nevojave të studentëve. Personeli akademik ka dëshmuar profesionalizëm në mësimdhënie dhe në kushtet e zhvillimit të mësimi online.</p> <p>Personeli akademik pranon dhe bën përpjekjet maksimale për të ofruar mundësi dhe metoda gjithëpërfshirëse dhe alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, nisur dhe nga karakteri</p>

	<p>profesional që ka programi i studimit.</p> <p>Në procesin e mësimdhënies janë futur teknikat moderne të mësimdhënies dhe janë ngritur mjedise mësimdhënëse si auditorë të pajisur me kompjutera, videoprojektorë, etj që mundësojnë një aftësim të studentëve në drejtim të shprehive praktike</p> <p>Që në fazën e projektimit të programit të studimit, parashikohen forma të ndryshme të veprimtarive formuese që përmban një disiplinë e caktuar, duke u dhënë shumë rëndësi veprimtarive praktike të formimit, siç janë: ushtrime, detyra, projekte, apo edhe praktika të lëndës</p> <p>Qëllimi i tyre është që studenti nëpërmjet këtyre veprimtarive formuese të aftësohet në zbatim praktik të njohurive teorike të dhëna në leksione. Një pjesë e tyre bëhen nën asistencën e detyrueshme të pedagogut, siç janë seminarët, konsultimet, etj, ndërsa një pjesë tjetër zhvillohen si punime të pavarura të studentit nën konsulencën e pedagogut, siç janë detyrat, projektet etj.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 12.1 Plani Mësimor DPMMT në hapje të programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Një prioritet i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të ekspertizës së pedagogëve dhe stafit të UMSH dhe FSHE është dhe mbështetja e stafit për trainimin përgjatë procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe mbështetja me mobilitete sidomos për qëllime specializimi, në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit në programin Erasmus dhe integrimi i njohurive dhe eksperiencës së marrë në universitete të huaja në punën e tyre didaktike e mësimore,</p> <p>Personeli akademik ndjek periodikisht agjenda për kualifikim në fushën e kërkimit dhe studimit shkencor për të ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Pjesëmarrja në trainime të brendshme apo dhe jashtë institucionit, në leksione të hapura dhe evente të ndryshme shkencore janë një mundësi konkrete për aktualizimin dhe thellimin e njohurive të fushës së angazhimit, për vendosjen e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm me to.</p> <p><i>Evidenca 25.1 Evidenca të lëvizjes së stafit akademik dhe administrative</i> <i>Evidenca 23. Programi i trajnimeve</i> <i>Evidenca 26. Përmbledhje e informacioneve shkencore në</i></p>

	<i>departamente 2022-2023</i>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i Fakultetit dhe departamentit reflekton seriozitet dhe përkushtim në detyrë. Stafi dallohet për kompetencë profesionale (pedagogët zotërojnë njohuri shumë të mira teorike dhe praktike për modulet që mbulojnë). Një pjesë e konsiderueshme e stafit kanë kryer shkollime/kualifikime/trajnime jashtë dhe reflektojnë dijet dhe praktikat më të mira në arsimin e lartë, duke patur aftësi shumë të mira në mësimdhënie. Të gjithë këta faktorë reflektohen tek performanca pozitive e studentëve dhe vlerësimet pozitive të tyre.</p> <p>Pedagogët krijojnë raporte të ndërsjella respekti reciprok me studentët, i mbështesin ata në kuadër të formimit të tyre profesional për të qënë sa më të përgatitur në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 9. CV e stafit akademik të programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Njësia për vlerësimin e programeve të studimit, mbështet vlerësimin e programit përmes njësisë përgjegjëse për programin DMM. NJSBCSHK i përmbahet një metodologjie të mirëpërcaktuar për të vlersuar dhe përmirësuar metdoat e mësimdhënies, metoda të cilat përfshijnë studentët në mënyrë active. Një metodoë shumë efikase është ajo e fokus grupeve, të cilët janë një burim i rëndësishëm i informacionit cilësor se si po zhvillohen metodat e mësidhënies dhe cilat janë problematikat. Gjithashtu, dy herë përgjatë një viti akademik, institucioni harton dhe shpërndan një pyetësor i cili plotësohet nga studentët. Në të janë përfshirë disa elementë vlerësues: matja dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, materialet mësimore, si dhe vlerësimi i infrastrukturës që ofrohet në këtë program studimi. Në këtë mënyrë studentët përfshihen për të dhënë mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i></p> <p><i>Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet</i></p> <p><i>Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,</p>	<p>Prioritet kryesor i UMSH-së mbetet kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik.</p> <p>Stafi i FSHE dhe DMM- së është i mirëorganizuar për të zhvilluar aktivitetin në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Struktura kryesore që mbështet dhe promovon përmirësimin e</p>

<p>koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies duke dhënë feedback mbi procesin tek departamentet është Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Karrierës, e cila është një zyrë që përmban dy seksione. Seksioni i Sigurimit të Cilësisë ka si përgjegjësi zhvillimin e të gjitha proceseve dhe procedurave për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë duke u mbështetur në manualat, rregulloret, format e ndryshme të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Një kuadër i rëndësishëm është edhe kuadri trainues për pedagogët e rinj dhe ata ekzistues, i cili përmban tematika të rëndësishme lidhur me metodat e mësimdhënies, metodat e kërkimit shkencor si dhe mundësitë e kapacitetet e institucionit si dhe jashtë institucionit për mbështetjen ndaj pedagogëve.</p> <p>Gjithasht pjesë e procesit të cilësisë janë edhe raportet që përpilon departamenti në fund të çdo viti akademik, mbi ecurinë mësimore dhe kërkimore ku evidentohen pikat e forta dhe nevojat për përmirësim. Të dhënat e pasqyruara raportet e departamentit si dhe në raportet e NJSBCSHK shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Në kuadër të zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, DMM dhe FSHE organizojnë leksione të hapura në mënyrë periodike. Gjatë leksioneve të hapura stafi i ri ndjek orë leksionesh nga stafi me përvojë ose mund të asistojë gjatë orëve të hapura nga titullarët e modulit. Nga Departamenti dhe për programin e studimit ndiqet dhe praktika e dhënies së leksioneve nga pedagogë të ftuar nga vendi ose të huaj.</p> <p><i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 23. Programi i trajnimeve</i> <i>Evidenca 30. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca 31. Plani i punës i NJSBCZHK</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.</i></p> <p><i>Puna e stafit të FSHE-së dhe rezultatet e arritura kanë qënë përgjithësisht të kënaqshme në drejtim të mësimdhënies dhe organizimit të tij.</i></p> <p><i>Personeli akademik përmirëson vazhdimisht programet e lëndëve duke alternuar metoda të ndryshme mësimdhënie në përshtatje të nevojave të studentëve.</i></p>

	<p>UMSH ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike e cila dëshkohet nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit që ka me institucione homologe si brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Pedagogët përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies si ato audiovizuale të alternuara me shpjegimin e tyre tradicional, por edhe duke diskutuar me studentët mbi pyetje të ndryshme të ngritura apo çështje të caktuara në mënyrë që të nxisë aftësinë e të menduarit dhe të të shprehurit të studentëve por edhe për ta bërë orën e mësimit më tërheqëse për ta. Sipas temave të caktuara studentët mund të realizojnë orë të caktuara në kompani apo institucione të ndryshme apo të ftohen pedagogë apo specialistë të fushës përkatëse. Këto alternime të mësimdhënies ndikojnë në rritjen aftësive të mësimnxënies së studentëve.</p> <p>NJSBCSHK është njësi që organizohehet për të promovuar cilësinë duke monitoruar procesin në bashkëveprim me departamentin për elementët e realizimit të programit mësimor, si mbulimi me materialeve studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave dhe nëse e vlerëson të arsyeshme propozon ndryshime.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kontrolli i dijeve shërben për të vlerësuar progresin e studentit gjatë periudhës së studimit në auditor dhe studimit individual, në përvetësimin e dijeve dhe për të matur aftësinë e tij profesionale të fituara gjatë ndjekjes së lëndës/modulit. Për programin DP në MMT mënyrat e vlerësimit janë të shprehura jo vetëm në rregullorene programit, por edhe në secilin prej syllabuseve të lëndëve. Kontrolli i dijeve për çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të punimit dhe prezantimit të detyrave të kursit, Provimit të ndërmjetëm, pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminare si dhe provimit përfundimtar, përkatësisht me 15%,</p>

	<p>30%, 15z5 dhe 40%.</p> <p>Informacioni mbi mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen për të marrë vlerësimet sipas komponentëve bëhen të njohura për studentët që në fillim të semestrit.</p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 14.1 Procesverbal mbledhje departamenti për syllabuset 09.2023</i></p> <p><i>Evidenca 32. Udhëzues për studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Ekziston nje procedure e mirepercaktuar ku cdo student gjatë prezantimit me modulën dhe pedagogen/un përkatës, merr prej saj/tij që në ditën e parë informacion të plotë rreth metodologjisë së kontrollit të njohurive, dijeve, aftësive si dhe kompetencave të tij. Gjithashtu në UMSH është bërë praktikë edhe hapja e klasave online gjatë fillimit të semestrit, ku studentët njihen më mirë me gjithë informacionet e nevojshme për zhvillimin e kursit apo lëndës.</p> <p>Studenti njihet me frekuencën e testimit gjatë vitit dhe merr informacion për formën e provimit përfundimtar (me shkrim apo me gojë); numrin e kontroleve ndërmjetëse që do të realizohen gjatë vitit, të parashikuara në planin kalendar, tema të detyrave të kursit etj.</p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 32. Udhëzues për studentët</i></p> <p><i>Evidenca 33. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Ka disa mënyra për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve duke u realizuar dhe në forma të ndryshme. Këto referohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe rregulloren e programit të studimit. Studentëve u tregohet qartësisht mënyra e sigurimit të literaturës (tekst në shitje, skript leksionesh, shënime në klasë, literaturë e huaj, etj.).</p> <p>Një listë e literaturës shtesë dhe të huaj është e listuar në syllabusin e modulit, të cilin pedagogu i lëndës ua vendos në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik.</p> <p>Në këtë syllabus ka të dhëna dhe mbi mënyrën e vlerësimit të studentit, testimet e ndërmjetme, etj.</p> <p>Testimet e njohurive behen permes rubrikave:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - testimi i ndërmjetëm, - aktivizimi në seminare, - realizimi i projekt kursit ose i detyrës së kursit dhe - provimi final. <p>Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e lëndës dhe planin mësimor të studimeve të cilat i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p>Testimi i dijeve dhe aftësive profesionale vlerësohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Në Rregulloren e Programit të Studimit, kreu V, nenet 19 dhe 20, shprehen qartë për mënyrat e vlerësimit të studentit gjatë ndjekjes së programit të studimit. Kjo ndarje respektohet shumë mirë dhe paraqitet në Syllabuset e çdo moduli.</p> <p>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024. Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</p>			
Konkluzione	<p><i>Njesia kryesore/bazë, ka hartuar rregullore të qarta ku shprehet mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Këto metoda janë të shumëllojshme dhe përfshijnë përveç provimit përfundimtar edhe vlerësimin e vazhduar përmes vlerësimit të aktivitetit të studentëve në seminarët dhe projektet apo detyrat e dhëna. Gjithashtu provimi i ndërmjetëm është pjesë e vlerësimit të vazhduar. Ndarja e përqindjeve të vlerësimit midis këtyre metodave është efektive dhe e mirëmenduar si dhe e pershtatshme për të pasqyruar një vlerësim tërësor të aftësive të studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe	Format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në disa prej rregulloreve, Rregullores e UMSH, në rregulloren e brendshme të FSHE, dhe neni 19 dhe 20 në rregulloren e programit të studimit. Sipas rregullores dhe

<p>reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>praktikës që aplikohet në këtë program studimi si Diplomë Profesionale, testimi e vlerësimi i njohurive paraqitet në pikat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë, ai i vazhduar që përfaqëson 60% të vlerësimit total dhe ai final që përfshin 40% të vlerësimit total. • Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: aktivizimet në orët e seminareve, testimi i ndërmjetëm, projektet apo detyrat e kursit, dhe provimi final. • Mënyrat e kontrollit të dijeve dhe përcaktimi i raporteve midis dy llojeve të vlerësimit, përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor. <p>Në fillim të çdo moduli të programit të studimeve DP në MMT pedagogu njeh studentët me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën, që do të përdoret në modulin përkatës. Gjithashtu syllabuset janë ndërtuar sipas modelit të VKM 41 dhe përmbajnë mënyrën e vlerësimit të vazhduar dhe final, në seksionin "Forma e kontrollit të dijeve".</p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sa u përket sistemeve të testimit, institucioni garanton që provimet në disa pjesë të tyre të shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe të rritet transparenca, duke përdorur disa forma elektronike të vlerësimit në Google Classroom, sic janë detyrat përmes Quizëve. Sa u përket sistemeve elektronike të vlerësimit ato përdoren nga institucioni dhe përmes sistemit elektronik të vendosjes së vlerësimeve, duke krijuar një sistem të përgjithshëm të mbledhjes dhe evidentimit të vlerësimeve të ndryshme dhe vlerësimit total.</p> <p><i>Evidenca 24. Manual i përdorimit të platformave elektronike</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Studenteve që në orët e para të leksionit ju bëhet me dije struktura e lëndës më përqindjet në vlerësimet, ku dallojnë dy zërat kryesor: ai i vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimi përfundimtar me provimin përmbyllës. Kjo masë vlerësimi është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit.</p>

	<p>Kontrolli i dijeve gjatë procesit mësimor merr në konsideratë: pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentit në leksione, seminare, ushtrime, punë laborator, detyra me shkrim (provime ndërmjetëse), detyra kursi, projekte kursi, praktika mësimore, etj. Në lidhje me disa pika të rregulloreve përkatëse për provimin final:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ai mund të organizohet me shkrim, me gojë ose në një formë të kombinuar (me shkrim e me gojë). Në rast të provimit të kombinuar, departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese. • ai organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve, për të cilën insitucioni ka një udhëzues të vecantë. • Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. <p>Baza ligjore në fuqi për vlerësimin final i cili merret bazuar mbi vlerësimin e vazhduar dhe atë të provimit final, është VKM 41, që përcakton edhe strukturën e syllabusit së bashku me një kuadër të vlerësimit të studentit.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 33. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës</i> <i>Evidenca 34.1 Format teze e provimit përfundimtar të lëndës</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në rregulloret e FSHE, Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit të studimit paraqitet edhe mënyra se si pedagogët duhet të japin feedback dhe komente lidhur me vlerësimet, përkatësisht me shënime në rastin e detyrave dhe provimeve të pjesshme, ndërsa në rastin e provimeve finale, pas shpalljes së rezultateve në sistem, studenti ka të drejtë të kontestojë rezultatin, duke marrë shpjegime dhe qartësime prej komisionit duke ballafaquar përgjigjet e studentit me përgjigjet e tezës. Pas ballafaqimit rregullorja i jep te drejtë komisionit të mbyllë notën përfundimtare të provimit në sistem.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i></p>



<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</p> <p>Sipas rregulloreve, njësia përgjegjëse ka procedurë të caktuara kontrolli në provime për shmangien e praktikave të gabuara dhe joetike, sic janë kopjimi në provime apo plagjiatura në detyra dhe projekte. Rregullore e UMSH për studimet universitare përcakton se studentët nuk mund të hyjnë në provim pa mjet identifikimi dhe gjithashtu ushtrohet kontroll mbi mjetet e pajisjet që mund të favorizojnë praktikën e gabuara dhe joetike. Secila prej rregulloreve përmban edhe rregullat për marrjen e masave në rast shkeljeje, ndaj studentit, duke përfshirë që nga vërejtjet e thjeshta e deri në përjashtim nga universiteti.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Evidenca 33. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritë, pasi procesi i vlerësimit është i mirëpërcaktuar dhe cdo metodë vlerësimi kontribuon në vlerësimin final me pikë dhe me notë. Kategorizimi i pikëve me notë përcaktohet në syllabus dhe në rregullore. Rezultatet jepen brenda afateve të përcaktuara. Më pas rregullorja përcakton edhe afatet e ankimimit dhe dhënien e përgjigjeve finale.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Evidenca 33. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rregulloret e programit të studimit, rregulloren e FSHE dhe rregulloren e organizimit të UMSH, neni 67, studentët kanë të drejtë për tu njohur me vlerësimin përpara se sa ai të regjistrohet në sistem si vlerësim përfundimtar, si dhe për ta ankimuar vlerësimin, në rast se nuk janë dakort, duke kërkuar rishikim të rezultatit. Kërkesa e studentit i drejtohet dekanit, i cili vlerëson situatën dhe ngre një komision rivlerësimi nëse e gjykon të arsyeshme. Komisioni rishikon tezën e provimit ose rimerr në provim studentin, sipas situatës. Në cdo rast, rregulloret shprehen qartë për procedurat dhe mundësojnë vlerësimin e duhur të studentëve.</p> <p>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	<p>Procedura e ndjekur është tepër transparente pasi palët, duke përfshirë dekanin dhe komisionin e rivlerësimit mbajnë të dhëna për procesin e vlerësimit dhe rishikimit dhe dërgojnë në</p>


Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	department vlerësimin e rishikuar. <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i>			
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është përmbushje plotësisht, duke qenë se të gjitha rregulloret në nivel universtar, në nivel fakulteti dhe në nivel programi studimi përmbajnë rregullat e duhura për vlerësimin e studentëve në mënyrë korrekte dhe duke pasqyruar dijet e plota të studentit. Gjithashtu ato përmbajnë procedura të qarta për procesin e ankimimit dhe transparencën e këtij procesi, duke ndikuar në rritjen e besueshmërisë e si rrjedhim cilësinë e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ gjithashtu u siguria për mes pyetjeve të studentëve që këto procedura po ndiqen në mënyrën e duhur, gjë që e garanton edhe eksperiencia afatgjatë institucionale, por edhe e departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4


Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit ka objektiva të qarta të lidhura me formimin e studentëve në aftësitë dhe kompetencat profesionale, këto janë shprehur në kurrikulën e studimeve profesionale. Gjithashtu nga të dhënat për studentët dhe studimi i tregut tregon që studentet e kane mundësi për punësim dhe karriere kryesisht në biznesin aktivitetet të lidhura me turizmin. Kjo është konsideruar si një prirje pozitive, përmes kurrikulave ku gjenden module qe furnizojne me njohuri, aftesi dhe kompetenca duke vleresuar përmes gjurmimit te studenteve pas diplomimit.</p> <p>Programi i studimit ka krijuar kompetenca në fusha të përshtatshme në mënyrë që diplomimi i studentëve të krijojë hapësirat e mjaftueshme për aftësimin e studentëve në fushat e përgjithshme dhe specifike, përmes lëndëve marketingu i turizmit, menaxhimi i turizmit, menaxhim akomodimi në turizëm, Resurset turistike të Shqipërisë, etj.</p> <p>Një ndër strategjitë e institucionit, ne funksion të rritjes së</p>

	<p>aftësive krijuese të studentit por edhe testimit të identifikimit të të gjitha aftësive të tij, është edhe sistemi i vlerësimit përmes vlerësimit të vazhduar, duke krijuar mundësi për vlerësimin e aftësive të buta si aftësitë krijuese të studentit, mendimi kritik, komunikim dhe bashkëveprim, njohuri dhe kapacitete për zgjidhjen e problemeve, etj. Programi krijon aftësi dhe kapacitete për të punuar në të gjithë nënsektorët e industrisë së turizmit.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 12.1 Plani Mësimor DPMMT në hyrje të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Aftësitë e veçanta në fushën e Teknologjisë së informacionit, jepen nga lëndë të formimit të përgjithshëm si Informatika (semestri 1) si dhe lëndë specifike si Sistemet Informatike të sektorit të Turizmit (Semestri 3). Ndërsa aftësitë në fushën humane, sociale, e komunikim jepen nga lëndët Shkrim dhe komunikim, Semestri 1, Hyrje në Marketingun Turistik, Semestri 2 , etika në Turizëm, semestri 2, BAZat e menaxhimit të burimeve njerëzore semestri 54, etj. .</p> <p><i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të lëndës, kapacitetet dhe aftësitë e fituara të studentit vlerësohen përmes formave të ndryshme të vlerësimit të dijes.</p> <p>Kompetencat që fiton studentit janë të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde dhe të analizuarat përtej analizave e shqyrtimit në përfundim të çdo lënde, apo përtej analizave periodike e vjetore, edhe gjatë vizitës në terren janë të diskutuara edhe me pergjegjesin e departamentit apo me njeri tjetrin. Ato ndikojnë për të rritur cilësinë e kurrikulës duke ndërgjegjësuar stafin dhe studentët me sfidën me të cilën është përballur programi në këto dy vite që kur është hedhur në treg.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të</p>



	<p>modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final.</p> <p><i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në lidhje me aspektin e zbatimit të njohurive dhe kompetencave të marra, kryesisht stafi akademik gjatë procesit të mësimdhënies nxit punën e studentit në dy aspekte: së pari gjatë seminareve me diskutime dhe detyra, trajtim të rasteve të studimit dhe ushtrimeve dhe së dyti nëpërmjet projekteve të kursit të cilat janë të vendosura në zbatimin e njohurive në kompani po ndërmarrje specifike. Gjatë takimeve në institucion kryesisht takimi me pedagogët e programit u diskutuan disa shembuj të ngritjes së kompetencave të studentit si puna në grup, komunikimi dhe zbatimi i njohurive, diskutimet me lektorët e ftuar të fushës së turizmit, përgjithësimi i rezultateve, etj., përmes realizimit të projekteve konkrete të kursit. Ndërkohë praktika profesionale përfshihet në kurrikul përgjatë semestrit 4. Kështu krijohet edhe klima e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe ndërthuren format e ndryshme të mësimdhënies duke rritur aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Sa u përket mobiliteteve UMSH ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh aktive duke lejuar patjetër mobilitetet e studentëve, duke i nxitur ata të marrin pjesë në shkëmbimet Erasmus plus, që janë të mundshme. Por nga ky program studimi nuk ka student të përfshirë në mobilitete, për arsye të mosekzistencës së programeve paralele, si diploma profesionale dhe mungesës së mundësive për të njohur kurse të zhvilluara jashtë në programe të ngjashme. Megjithatë nga vizita në institucion u argumentua se shkëmbimet e studentëve nuk mund të jenë të aplikueshme për diplomat profesionale, të kësaj natyre.</p> <p><i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Evidenca: Vizita në institucion me Zyrën e Zhvillimit të</i></p>



	<i>Karrierës</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjithë personeli akademik i programit të studimit është i angazhuar për të zbatuar disa risi lidhur me procesin e mësimdhënies, ku përfshihen edhe ftesa e lektorëve, sidomos nga ana e industrisë dhe Biznesit turistik apo ekspertëve të njohur në fushën e turizmit. Kryesisht në lëndë aplikative si “Resurset Turistike të Shqipërisë”, apo menaxhimi i akomodimit, etj, ka mundësi të realizohen orë të hapura dhe janë realizuar disa orë pranë biznesit, bazuar në diskutimet me stafin e programit, por ende më zyrtarisht duhet të realizohet procesi i këtyre orëve dhe metodave. <i>Evidenca: Vizita në institucion me Pedagogët e programit të studimit</i> <i>Evidenca: Vizita në institucion me Studentët e programit të studimit</i>			
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është e plotë për shkak të kurrikulës e cila përfshin lëndët dhe modulet e duhura për krijimin e aftësive dhe kapaciteteve të studentëve lidhur me menaxhimin dhe marketingun e Turizmit. Nga ana tjetër kësaj kurrikule i shtohen dhe përpjekjet e stafit për të realizuar aktivitete dhe angazhuar studentët që me aktivitetet praktike të aplikojnë njohuritë duke rritur kapacitetet e tyre në profesion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Brenda një muaj nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bëjnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe asaj të departamentit si dhe informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. Studentët diplomohen me vetëm me provim formimi pasi kjo është një diplomë profesionale. Të gjitha rregullat për provimin e formimit si dhe një bazë e rëndësishme pyetjesh u janë komunikuar studentëve, por gjithashtu janë depozituar në

	<p>bibliotekën e UMSH.</p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 34.2 Format teze e provimit të formimit</i> <i>Evidenca 36. DPMMT Program orientues per provim formimi_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti, suporton studentët për të realizuar me sukses detyrimet përmbyllëse jo vetëm përmes mbështetjes me këshilla dhe kohë mentorimi fizik, por edhe përmes udhëzuesit, një program që përmban gjithë tematikat dhe materialet që duhet të konsultojë studenti për provimin e formimit.</p> <p>Pedagogët krijojnë një strukturë komunikimi me studentin dhe u vënë në dispozicion materiale dhe udhëzimet e nevojshme gjatë procesit të përgatitjes për provimin, si një nga detyrimet kryesore përmbyllëse të studentit.</p> <p><i>Evidenca 36. DPMMT Program orientues per provim formimi_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i provimit final të formimit përmban materiale nga lëndët më të rëndësishme dhe tematikat më me peshë që student ka përgatitur përgjatë studimeve dy vjecare. Ai është në dispozicion të të gjithë studentëve përmes bibliotekës. Lëndët dhe modulet përfaqësohen nëpërmjet pyetjeve sips rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p>Komisioni i posaçëm i ngritur për qëllimin e mbrojtjes së provimit final të diplomës përbëhet nga stafi departamentit dhe kryetar përgjithësisht përgjegjës e departamentit. Teza e provimit që u jepet studentëve përmban pyetje nga fondi i krijuar dhe i shpallur pulbikisht duke përfshirë një shumëllojshëmri fushash të studimeve akademike profesionale.</p> <p><i>Evidenca 36. DPMMT Program orientues per provim formimi_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</p>	<p>Nuk aplikohet ky kriter në këtë diplomë profesionale.</p>

rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Gjithashtu njësia bazë mbështet studentët për realizimin e aktivitetit të tyre lidhur kryesisht me aspektet praktike për secilën lëndë. Por, në rastin e DP MMT ka pak mundësi për analizave të thelluara, teste apo eksperimente, duke qenë një diplomë m,e fokus profesional. <i>Evidenca 12.2 Plani Mësimor DPMMT viti akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Studenti vlerësohet për provimin e diplomës me notë nga komisioni i diplomës i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. Vlerësimi bëhet i bazuar në ndarjen e notave sipas grupit të pikëve, që janë përcaktuar edhe sipas rregullireve të fakultetit dhe rregullores së programit të studimit. <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas marrjes së vlerësimit përfundimtar, studenti përfundon studimet dhe ka të drejtë të diplomohet duke u pajisur me diplomën dhe suplementin e diplomës, listën e notave, sic është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Sipas kërkesave të studentit, në përfundim ai ka të drejtë të marrë një kopje të plotë të të gjithë progrmit të studimit të zhvilluar gjithashtu të shoqëruar sipas kërkesave me syllabuset e programit të studimit. <i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 37.1 Modeli i diplomës për programin DPMMT</i> <i>Evidenca 37.1 Modeli i diplomës për programin DPMMT</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kopje të dokumentacionit të studentit janë të ruajtura pranë institucionit sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme të institucionit, departamentit dhe programit të studimit. <i>Evidenca 37.1 Modeli i diplomës për programin DPMMT</i>
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është përmbushje plotësisht pasi gjithë procedurat e detyrimeve përmbyllëse janë parashikuar në rregulloren e institucionit, rregulloren e programit të studimit dhe gjithashtu zbatohen nga departamenti dhe stafi i programit në mënyrë rigoroze.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Dokumenti primar që paraqet orientimin e UMSH drejt metodave inovative në mësimdhënie bazuar mbi fushën e studimeve është statuti i UMSH, Plani strategjik i zhvillimit të UMSH si dhe rregullorja e organizimit të UMSH. Këto janë dokumentet orientuese dhe udhëzuese në nivel institucional që pasohen gjithashtu nga roli dhe funksioni i NJSBCZHK, që në funksionin e saj ka dhe orientimin për përmirësimin e mësimdhënies duke u bazuar në metodat inovative. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt luajnë edhe shkëmbimet e stafëve akademike në kuadër të marrëveshjeve Erasmus plus, për trainime dhe mësimdhënie.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit i UMSH</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBCZHK është njësia kryesore përgjegjëse që institucioni ka ndërtuar për të zhvilluar mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kjo njësi, përshkruan në rregulloren e organizimit dhe punës së saj mekanizmat për kontrollin e cilësisë, që përfshijnë si metoda cilësore ashtu edhe ato sasiore, nëpërmjet fokus grupeve dhe pyetësorëve për studentët. Nga ana tjetër bashkëveprimi dhe bashkërendimi i punës me departamentet dhe fakultetin krijon mundësinë e përdorimit efikas të informacionit të mbledhur për të përmirësuar cilësinë dhe rritur inovacionin. Ka formate specifike për vlerësimin e punës së pedagogut dhe lëndës.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 30. Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues.</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të zhvilluara nga NJSBC vendosen në</p>

përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	dispozicion të njëjësive të ofrimit të programeve të studimit, pra edhe të Departamentit që ofron DP MMT. Nga ana tjetër raportet përmbledhëse të nxjerra nga monitorimet janë pjesë e publikimeve, si dhe rezultatet totale janë pjesë e rubrikës që NJSBCZHK ka në web-siten e UMSH, duke realizuar transparencën që është aq e domosdoshme në procesin e monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë. <i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i>			
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Raportet e nxjerra nga vëzhgimet dhe monitorimi i NJSBCZHK diskutohen në mënyrë institucionale në të gjitha nivelet e drejtimit, duke dërguar informacionin e përpunuar deri në nivel departamenti dhe pedagogu. Këto diskutime bëhen me qëllimin për të realizuar përmirësime të vazhdueshme patjetër edhe duke promovuar praktikave të mira, duke sjellë në mbledhjet apodiskutimet me stafin, ato shembuj të pedagogëve apo lëndëve që kanë patur feed-back un më të mira nga anketat e studentëve. <i>Evidenca 17. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca: Vizita në institucion, Takimi me NJSBCZHK</i>			
Konkluzione	<i>Ka një strukturim të mirëpërcaktuar të Zyrës kryesore që merret me vlerësimin e cilësisë, NJSBCZHK. Gjithashtu UMSH ndërmerr të gjitha praktikave të nevojshme dhe zbaton të gjitha udhëzimet dhe orientimet për kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë, duke përfshirë në proces të gjithë aktorët, duke vendosur në qendër studentin, por edhe duke diskutuar me stafet akademike, me synim identifikimin e praktikave të mira dhe novatore në proceset akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush

standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Kërkesat ligjore në fuqi për stafin akademik përcaktohen me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të tij si dhe të Statutit të UMSH e Rregullores së organizimit të UMSH përbërja e stafit akademik është e tillë që përmban staf me titullin minimal Master shkencor.

Aktualisht numri i stafit akademik i departamentit DMM, është 15 pedagogë, nga të cilët 11 PAE dhe 4 PAK. Shpërndarja sipas titujve dhe gradave është e tillë që ka 2 pedagogë me gradën Prof. Dr, 3 me gradën Prof. Asoc, 5 me gradën Dr, 4 Dr në proces dhe një me gradën Msc. Ndërsa gjithë stafi i programit të studimit përbëhet nga 20 veta, personel akademik me kohë të plotë dhe me kontratë nga ku 18 janë me kohë të plotë dhe 2 janë me kontratë. Informacion më i detajuar mbi titujt dhe gradat shkencore gjendet në tabelën e anekseve mbi stafin akademik. Stafi i programit i përmbush kriteret ligjore për ekspertizën në fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike lidhur me programin e studimit.

Stafi akademik sipas titujve/gradave	2023-2024		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	0	0	0	0
Prof. Asoc. Dr.	1	1	1	0
Dr.	7	1	1	1
Dr. në proces	6	0	6	0
Msc.	4	0	3	0
Total	18	2	11	1

Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kriterëve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan komunikimi me departamentin dhe dekanatin përkatës, sipas intervistës me

	<p>drejtorin e burimeve njerëzore. Ndërsa kriteret e përgjithshme përcaktohen nga Senati i Institucionit, kriteret e vecanta përcaktohen nga njësia bazë, sipas nevojave të saj për staf akademik dhe miratohen nga Rektori. Në rastet kur ka kritere të vecanta ato lidhen kryesisht me kualifikimet e mëtejshme, eksperiencën brenda e jashtë vendit dhe sidomos të lidhur me pozicionin vacant, lëndët apo modulet e pambuluara dhe detyrat lidhur me programin specific.</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhese e Tabelave per Programin e studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 9. CV e stafit akademik të programit të studimit DPMMT</i></p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e stafit akademik përgatitet në çdo fillim viti akademik nga Departamenti dhe përgjegjësi i departamentit duke u bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimet e MAS. Ngarkesa propozohet nga DMM dhe miratohet nga Senati Akademik. Personeli akademik efektiv mbulon pothuajse 70% të ngarkesës. Ngarkesa e stafit përcaktohet bazuar mbi titujt akademikë dhe gjithashtu udhëzimet dhe rregulloret për orët e zhvilluara mbi normë, të cilat nuk mund të jenë më shumë se 200 orë dhe në raste të vecanta me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, mund të jetë edhe 100 orë më tepër.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH</i></p> <p><i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit i UMSH</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i></p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stafi i departamentit dhe i programit të studimit është i qëndrueshëm, për disa vite, dhe kjo është një karakteristikë themelore e stafit të departamentit dhe programit të studimit. Gjithë stafi akademik është i punësuar me kontratë të përhershme ose të përkohshme sipas kategorive dhe kushteve të departamentit dhe programit të studimit.</p> <p>Fondet buxhetore për pagat menaxhohen nga përgjegjësi i sektorit të pagave dhe bursave. Përlllogaritja e pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë bëhet bazuar mbi VKM përkatëse dhe gjithashtu deklarohen online të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.</p> <p><i>Evidenca 9: CV e stafit akademik të programit të studimit DPMMT</i></p>

	Evidenca 40: Kontrata e Punës tip PAE
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>UMSH ka ndjekur procedura të qarta për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, e cila bazohet në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, Kodin e Punës në RSH, statutin dhe rregulloren e UMSH.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në institucion përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e vendit vacant, në mediat elektronike dhe në institucion, hartimi i ofertës së punës, kriteret e pranimit, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit.</p> <p>Procedurat, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, procedura e konkurrimit, rezultatet, afatet e ankimimit janë objekt i rregullores</p> <p>rregullorja për organizimin e UMSH si dhe orientohen nga Udhëzuesi përkatës.</p> <p>Evidenca 1. Statuti UMSH Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH Evidenca 41. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit Evidenca shitesë: Aplikime Staf 2023-2024</p>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Në statutin e UMSH, përcaktohen kategoritë personelit ndihmës akademik si me karakter mësimor/shkencor dhe ndihmës akademik administrativ. Personeli ndihmës akademik i angazhuar në DMM dhe përkatësisht në këtë program studimi është personel ndihmës akademik administrativ, në nivel institucional i përcaktuar me përgjegjësitë përkatëse për çdo program studimi, si edhe për programin DP në MMT, si dhe ka përgjegjësinë për mbështetjen e stafit akademik në funksion të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</p>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të	<p>Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik dhe atë mbështetës menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, duke përfshirë ata me kontratë të përhershme efektive dhe ata me kontratë të përkohshme të personelit jashtëm. Dosja përmban dokumentacionin personal të çdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të</p>

<p>përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentuan mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit, PAE dhe PAK dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Drejtorja e burimeve njerëzore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të përditësuar për secilin anëtar të stafit. Ndërkohë sipas rregullores së studimeve për programin e studimit DP në MMT, të gjitha të dhënat për programin e studimit, ndarjen e ngarkesave për stafin dhe të dhëna për përgjegjësin e departamentit mbahen në departament si dhe në dekanat.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 41. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personel i departamentit DMM, i cili garanton një proces të praktikave, të mbështetur nga marrëveshjet me organizata të biznesit dhe administratës publike, në nivele vendore e qendrore. Procesi ndiqet nga pedagogët e përcaktuar dhe procedurat janë të mirëpërcaktuara në rregulloren përkatëse. UMSH ka bërë një sërë marrëveshjesh të rëndësishme ku institucionet (departamenti, komisioni) marrin përsipër garantimin e vendit të realizimit të praktikës, në rastet kur nuk përcaktohet me dëshirën e studentit. Studentët pas periudhës së ndjekjes së praktikës, sjellin në institucion praktikën më të mira, nëpërmjet raportimit dhe prezantimit dhe komisioni i praktikës merr në provimin e praktikës studentët, duke nxjerrë listën e notave. Dokumentacioni gjithashtu paraqet listën e studentëve dhe kompanive/organizatave ku ata do të realizojnë praktikën për çdo vit.</p> <p>Në përfundim të studimeve realizohet Provimi i Diplomimit, ku vendoset në dispozicion komisioni Ad-Hoc i provimit.</p> <p>Zhvillimi i praktikave profesionale mbështetet nga departamenti dhe fakulteti nëpërmjet marrëveshjes me ndërmarrje, organizata dhe 2 institucione, duke garantuar realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Për këtë realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Departamenti mban marrëdhënie edhe me zyrën Alumni dhe karrierës për identifikimin e kompanive që mund të jenë pjesë e listës për praktika mësimore. Është me rëndësi të theksohet se</p>

	<p>departamenti mban përgjegjësi për përcaktimin e vendit të praktikës, duke përfshirë dhe mjediset. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe udhëheqësit të praktikës, i cili ndjek dhe raporton për studentin, janë të shprehura në rregulloren përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 15. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, jo vetëm është përcaktuar që të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës, por edhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Kështu në përfundim të praktikës mësimore personeli mbikqyrës përpilon një relacion mbi punën e kryer nga studentit dhe vlerëson ecurinë e tij në periudhën që ai ka kaluar pranë ndërmarrjes / kompanisë. Studenti ka për detyrë të ndjekë të gjitha rregullat në institucionin pritës dhe në fund të periudhës realizon relacionin e praktikës, i cili së bashku me gjithë dokumentacionin nga kompania, do të vlerësohet nga komisioni Ad-Hoc i ngritur për këtë qëllim.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 42. Udhëzim për praktikat dhe Formularët tip të praktikës</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit realizohet nga një departament me rëndësi DMM, brenda Fakultetit si dhe ka pedaogë me titujt dhe gradat si dhe eksperiencën e duhur për të mbështetur proceset e mësimdhënies, kërkimit shkencor si edhe të gjitha procedurat e studentëve deri në diplomim si mbrojtjet e praktikave dhe diplomave. Rregulloret përkatëse janë të qarta dhe të mirëzbatuara lidhur me të gjitha pikat më sipër.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Ambjentet e UMSH dhe FSHE janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe pedagogëve të fakultetit e si rrjedhim edhe të studentëve të programit DP në MMT. Ambjentet fizike vendosen në godinën me salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e lëndëve aplikative si Informatikë, gjuhë e huaj në turizëm, etj. Studentët dhe pedagogët kanë akses në mjediset ku hapësirat janë të bollshme dhe të pajisura gjithaëshu me teknologjitë përkatëse të Informacionit dhe Komunikimit.</p> <p><i>Evidenca 43. Relacion i Verifikimit të Godinës</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Çdo sallë e leksioneve është pajisur me videoprojektor dhe disa janë pajisur edhe me laptop. Ndërs disa salla janë pajisur me videoprojektor ndërkohë që ka videoprojektor në department i cili përdoret në këto raste, sipas planifikimit të orëve. Për cdo leksion mundësohet pra prezantimi PPT. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Pajisjet janë të reja në laboratorët e UMSH dhe situata është relativisht e kenaqshme për realizimin e orëve laboratorike. Në laboratorë mungon videoprojektori apo pajisje që do ta bënin mësimin më ndërveprues dhe funksional në to.</p> <p>Gjithashtu infrastrukturën në UMSH janë përshtatur sipas standarteve edhe për studentët me aftësi ndryshe.</p> <p><i>Evidenca 43. Relacion i Verifikimit të Godinës</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas vizitave në institucion dhe në strukturat e FSHE, u pa se laboratorët janë të përshtatur për realizimin e orëve të informatikës, financë, kontabilitet, Teknologji Informacioni në Turizëm, etj., duke patur mundësi të Softwareve përkatës aplikativë për realizimin me rigozitet të programit të këtyre lëndëve.</p> <p>Gjithashtu është në funksion salla e konferencave, për aktivitete promovuese në FSHE, dhe si rrjedhim edhe në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>Anketimet e studentëve kanë dhënë vlerësim pozitiv për laboratorët dhe programet lidhur me profesionin e tyre.</p> <p><i>Evidenca 43. Relacion i Verifikimit të Godinës</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit</p>	<p>Në funksion të këtij programi studimi janë disa laboratorë</p>

të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	informatike dhe gjuhë të huaj, ku studentët realizojnë orët e seminareve, si edhe labororet. Studentët mësojnë programet aplikative në këto lëndë. Duke parë edhe mudnësitë e punësimit në fushat ekonomike dhe financiare, sipas studimit të tregut dhe vizitës në institucion, këto janë laboratë shumë të rëndësishëm për aftësimin e studentëve. <i>Evidenca 43. Relacion i Verifikimit të Godinës</i>			
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standartit është e plotë duke qenë se mjediset mësimore dhe infrastruktura janë shumë të përshtatshme dhe të kompletuara për të realizuar me sukses programin e studimit dhe gjithashtu për të rritur kapacitetet e studentëve të lidhura me tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programin e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave. Numri i titujve është i lartë, rreth 4440 tituj librash duke përfshirë 26424 kopje për këta tituj për të gjitha fakultetet dhe departamentet e UMSH. Ka po ashtu tituj të revistave, proceedings te konferencave kombëtare e ndërkombëtare, etj.</p> <p>Sot ka vlerë më shumë aksesit on-line në bibliotekat dixhitale dhe kjo garantohej nga UMSH përmes bibliotekës elektronike me 327000 tituj të disponueshëm për të regjistruarit. Duke qenë se ka bibliotekë dixhitale në dispozicion, kjo siguron më shumë cilësi në literaturën për programin e studimit, përmes titujve që në pjesën më të madhe janë të fushës ekonomike.</p> <p>Gjithashtu departamenti ka bërë kërkesë që biblioteka të shtohet me titujt me interes në fushën e menaxhimit dhe</p>

	<p>marketingut të turizmit.</p> <p>Evidenca 46. Kërkesë për libra DMM Evidenca 45. Material per bibliotekën https://drive.google.com/file/d/1U5hQt9ZqdckNMDnW3FW6qOvUUhMjx5_z/view</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Burimet e bibliotekës janë kryesisht burime për stafet akademike, por edhe studentët informohen dhe nxiten më shumë në përdorimin e këtyre burimeve, sidomos nëpërmjet mundësive të barabarta për tu shfrytëzuar nga të gjithë. Duhet thënë se studentët e UMSH dhe si rrjedhim të DP në MMT kanë mundësi të menjëhershme për përdorimin dhe aksesin e burimeve online duke qenë se kanë një llogari në sistem dhe adresa e-maili institucionale.</p> <p>Evidenca 45. Material per bibliotekën Evidenca: Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka në fondin e saj tituj ku përfshihen tekste mësimore si dhe literature ndihmëse si dhe janë të kategorizuara në tituj shqip dhe të huaj. Gjithashtu ka tituj nga periodikë të seleksionuar si edhe të paseleksionuar apo edhe tituj nga periodikë të shkarkuar si Elsevier dhe tituj nga periodikët online. Mbulohen afërsisht të gjitha modulet mësimore të programit të studimit dhe departamenti përpiqet të përditëjë me titujt e nevojshëm për programin e studimit. Diskutimi me pedagogët e programit të studimit vuri në pah se shumë pedagogë kanë mbështetur me cikle leksionesh të miratuara.</p> <p>Evidenca 45. Material per bibliotekën Evidenca: Vizita në Institucion, takimi me pedagogët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas informacionit mbi bibliotekën dhe rregulloret e programit të studimit studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Madje mjediset e saj janë të pajisura me kompjutera dhe Internet, ku studentët mund të shfrytëzojnë pa kosto për projektet e tyre të kursit, detyra, orare të studimit dhe leximit, e aksesit online nëpërmjet abonimeve të cilat janë të listuara tek Evidenca e materialit mbi bibliotekën.</p> <p>Evidenca 45. Material per bibliotekën Evidenca: Vizita në Institucion, takimi me pedagogët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe</p>	<p>Biblioteka e UMSH është e pajisur me programin COBIS me të drejta të plota, për menaxhimin e katalogut të bibliotekës</p>

<p>kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>dhe gjithashtu jep mundësinë e aksesit në burimet e ndryshme elektronike ku institucioni është abonuar falë iniciativave të ndryshme për akses online të librave dhe revistave shkencore apo artisitke, databazave online të artikujve.</p> <p>UMSH është gjithashtu pjesë e EIFL (Electronic Information For libraries), me synim përdorimin e platformës, Edëard Edgar Publishing, e cila përfaqësohet nga Biblioteka e Akademisë së Shkencave.</p> <p>Evidenca 45. Material per bibliotekën Evidenca: Vizita në Institucion, takimi me pedagogët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në një orar të përshtatshëm me orarin e tyre mësimor, duke patur parasysh që oraret e zhvillimit të mësimin janë paralelisht me këto orare dhe me orë pushimi, ku studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës të pajisura edhe me kompjutera dhe Internet. Kapacitetet e saj janë të përshtatshme për përgjigjen e numrit të studentëve të programeve të ndryshme të studimit dhe të programit MMT.</p> <p>Evidenca 45. Material per bibliotekën Evidenca: Vizita në Institucion, takimi me pedagogët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë</p>	<p>Raportimi për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe për përditësimin realizohen nga stafi i bibliotekës. Pedagogët e stafit të programit në analizën në departamente japin informacion lidhur edhe me gjendjen e literaturave si dhe përditësimin e leksioneve dhe materialeve të cilat u shërbejnë studentëve por edhe fondit të bibliotekës. Departamenti ka bërë edhe kërkesë specifike për tituj, sipas evidencave në institucion dhe vizitës.</p> <p>Evidenca 46. Kërkesë për libra DMM Evidenca 45. Material per bibliotekën</p>

kërkesat për tituj.									
Konkluzione	<i>Institucioni plotëson të gjitha kriteret e lidhura me bibliotekën si një nga infrastrukturat bazë për zhvillimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies. Institucioni vë në zbatim të gjitha masat për përdorimin në qendër të vëmendjes së bibliotekës dhe infrastrukturave të saj në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët dhe profesorët.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	<p>Sistemi i Menaxhimit të të dhënave të studentëve është një sistem elektronik në UMSH i cili ruan dhe përpunon gjithë të dhënat e studentëve dhe është i aksesueshëm nga vetë ata, stafi akademik, administrative dhe drejtimi. Informacioni megjithatë ruhet edhe në Hard-copy në regjistrat që mbajnë informacionin e studentëve, duke përfshirë regjistrimin, regjistrat e arritjeve, vlerësimit dhe diplomimit. Nga ana tjetër sistemi elektronik i institucionit përdoret për hedhjen e të dhënave për regjistrimin e studentëve, faturat dhe pagesat, vlerësimet e studentëve, klasat transkriptet etj.</p> <p>Gjithashtu statuti i UMSH parashikon rastet dhe strukturat për menaxhimin e të dhënave dhe strukturat për menaxhimin e të dhënave.</p> <p>http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</p> <p>Evidenca 24. Manual i përdorimit të platformave elektronike</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi elektronik i Menaxhimit të Informacionit gjithashtu është planifikuar për menaxhimin e informacionit të stafit akademik, duke përfshirë orarin, lëndët nën përgjegjësi dhe kurset brenda një viti akademik. Informacioni në sistem ruhet i plotë dhe është i konsoliduar për të gjitha nivelet akademike, administrative dhe drjtuese. Detyrat janë të qartësuara përmes rregulloreve përkatëse edhe sa i përket sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit. Ai lehtëson dhe kontribuon në efikasitetin e punës në të gjitha nivelet administrative, punën e departamenteve dhe programit.</p>

	<p>njësive kryesore.</p> <p>Evidenca 24. Manual i përdorimit të platformave elektronike http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Secilit student i hapet një llogari e dedikuar që në fillim me regjistrimin e tij në UMSH për të patur akses në informacionet e duhura për studentin, programin e studimit, kurset, oraret, vlerësimet etj. Gjithashtu sistemi ka akses të dedikuar përmes llogarive personale log-in për për pedagogët dhe stafin administrativ, ku secili ka akses në infoacionet e dedikuara për të.</p> <p>Evidenca 24. Manual i përdorimit të platformave elektronike http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Studentëve në UMSH – SMSUMSH - ka të integruar pjesën që mund të lidhet me bashkëveprimin interaktiv dhe format e shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Studenti ka akses jo vetëm në informacionet me natyre akademike, por edhe në ato me natyre financiare, kohën dhe metodën e pagesave, statusin e pagesave individuale, etj. Kështu nuk ka nevojë që student të kontaktojë zyrat përkatëse dhe është përmirësuar sistemi i komunikimit të brendshëm. Sistemet G-Suite dhe Zoom cloud meeting janë aktivizuar gjithashtu nga institucioni gjatë vitit 2020, në periudhën e pandemisë dhe vazhdojnë ende të përdoren me efikasitet për rritjen e komunikimit si Brenda ashtu edhe me aktorët jashtë institucionit.</p> <p>Evidenca 24. Manual i përdorimit të platformave elektronike</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron monitorim në kohë reale të vlerësimeve dhe realizimit të aktivitetet akademik, nëpërmjet disa tipeve të raporteve në SMSUMSH të cilat mund të aksesohen në kohë reale nga drejtimi për të monitoruar më thellësisht aktivitetin akademik, dhe atë kërkimor shkencor. Të tilla raporte mund të përmendim: raportet individuale mbi prezencën e stafit, për frekuentimin e studentëve, për cilësinë e mësidhënies, përfundimin e vlerësimit brenda afateve, etj.</p> <p>Evidenca 24. Manual i përdorimit të platformave elektronike</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të</p>	<p>Duke studiuar Web-site të UMSH shohim se ky kriter përmbushet plotësisht pasi informacioni është i përdituar, dhe i plotë në lidhje me programin e studimit DP në MMT.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/65188528b779f.pdf</p>

njesisë përgjegjëse për programin e studimit.									
Konkluzione	<i>UMSH ka në funksionim një sistem të elaboruar të menaxhimit të Informacionit, i cili shërben për komunikim, informim dhe ndërveprim të studentëve, pedagogëve dhe stafëve administrative dhe niveleve drejtuese në UMSH. Sistemi ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e punës dhe mbështetjen e aspektit si akademik, ashtu edhe atij kërkimor shkencor dhe administrativ, duke qenë një pikë e fortë në procesin e zhvilluar dhe mbështetur prej UMSH në ofrimin e shërbimeve në Arsimin e Lartë.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucionit dhe pjesëve përbërëse të tij. Në bashkëveprim me ligjin e buxhetit, si edhe me udhëzimet përkatëse, por edhe me komponentin administrative, tashmë të ndarë nga ai kërkimor shkencor, në universitete, është e mundur të kalohet deri në nivelin e programeve të studimit. Planifikimi i buxhetit në UMSH bëhet bazuar në të gjitha dokumentet themelore të institucionit, duke u bazuar që në nevojat e programeve të studimit në departamente dhe duke u konsoliduar më tej nga njësitë kryesore dhe në nivel institucional. Në relacionin për realizimin e buxhetit dhe planifikimin, mund të evidentohen elementet e realizimit financiare të buxhetit, dhe koston mesatare të studentëve. Gjithsesi kjo kosto ndryshon në varësi të grantit dhe numrit të studentëve. Parashikimet për vitete e arshshme bëhen në projekt buxhetin afatmesëm. Të gjitha parashikimet financiare dhe planifikimi bëhen bazuar mbi të gjitha procedurat ligjore për institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 47.2: Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidenca 47.1: Tabela e Raportit Financiar</i></p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Planifikimi financiar fillon që nga njësia bazë me kërkesat e paraqitura nga përgjegjësi i departamentit në dekanat dhe më pas në senatin akademik dhe bordin e administrimit. Planifikimi përmban edhe kosto si shpenzimet për bibliotekën dhe materiale të tjera didaktike të nevojshme. Analiza financiare dhe raportet, paraqiten në rektorat, senatin akademik dhe marrin miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit. Në mbyllje të cdo cikli të plotë studimi institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e fundit dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Megjthatë në analizat dhe planifikimin e finalizuar nuk ka specifikime apo ndarje sipas programeve të studimit, sipas një praktike të përgjithësuar në institucion.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 47.2: Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidenca 47.1: Tabela e Raportit Financiar</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni përgatit raportet vjetore financiare dhe gjithë procedurat për miratim të vendimeve që lidhen me buxhetin dhe financat përcaktohen në statut dhe rregullore, të cilat zbatohen me rigorozitet. Sa i përket auditimit periodik, ka një procedurë që institucioni ndjek që pas cdo raportimi financiar angazhon një auditues të jashtëm, Kompani auditimi të pavarur, duke përmbushur detyrimet ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 47.2: Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidenca 47.1: Tabela e Raportit Financiar</i> <i>Evidenca 47.3 Raporti i Auditit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Raportimet janë në nivel institucional dhe apo të lidhura me realizimin e buxhetit nuk shkojnë deri në nivel programi studimi. Por kontrolli i vazhdueshëm nga administrator dhe nivelet administrative, korrigjohen shmangiet nga planifikimi deri në nivel departamenti dhe në të gjithë institucionin.</p> <p><i>Evidenca 47.2: Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidenca 47.1: Tabela e Raportit Financiar</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të</p>	<p>Qëndrueshmëria financiare e institucionit garantohehet dhe certifikohet nëpërmjet pasqyrave financiare dhe raportit financiar. Ato evidentojnë se edhe programi i studimit ka kapacitete për të garantuar një shëndet financiar në vazhdimësi, sidomos për shkak të rritjes së numrit të programeve të studimit</p>

mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	dhe numrit të studentëve në disa prej tyre. <i>Evidenca 47.2: Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidenca 47.1: Tabela e Raportit Financiar</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni realizon detyrimet ligjore mbi buxhetimin dhe analizat financiare, vendimmarrjen për buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme, sipas të gjithë legjislacionit në fuqi, gje që lejon të zbatohet buxhetimin, evedentimin e kostove dhe analizave financiare dhe auditimin në mënyrë të qëndrueshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje paraqiten në statutin dhe rregulloret përkatëse të UMSH dhe FSHE. Këto politika ndikojnë në informimin dhe mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë procesit, që nga regjistrimi në UMSH për programe studimit, e deri në përfundim të studimeve. Në këtë program studimi ka përfunduar studimet cikli i parë i studentëve dhe tashme pritet të përfundojë edhe cikli i dytë.</p> <p>Sa i përket ciklit të plotë, deri në dalje UMSH ka disa zyra që mbështesin studentët përgjatë qëndrimit të tyre, si departamenti dhe zyra për zhvillimin e karrierës. Të gjitha</p>

	<p>proceset gjatë programit të studimit, në diplomim dhe pas diplomimit mbështeten nga zyrat e UMSH.</p> <p><i>Evidenca 2: Plani strategjik i zhvillimit i UMSH</i> <i>Evidenca 3: Strategjia e zhvillimit të programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 11: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas rregullores FSHE, studimet në MMT mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe të huaj sipas kriterëve të përcaktuara. Strukturat e njësisë bazë, Zyrës së Studentëve dhe Qendrës së KARRIERËS japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar ata në kushte të barabarta. Ofrimi i informacionit dhe shërbimeve bëhet sipas nevojave të studentëve dhe transparenca e informacionit mbështet procesin për garantim të të drejtave të njëjta.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 11: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/12/kontakt</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni propozon kuotat e pranimit si edhe kriteret e pranimit, që në rastin e këtij programi nuk është se janë të vecanta. Ato shpallen në Web-siten e UMSH. Pranimi në këtë program studimi bëhet sipas kërkesave ligjore në fuqi për çdo student që ka përfunduar maturën shtetërore, apo çdo program të njohur studimi të ekuivalentuar nga MAS. Pranimi dhe regjistrimi i studentëve bëhet sipas udhëzimeve dhe në bashkëpunim me të gjitha strukturat shtetërore të ngritura për zbatimin e maturës shtetërore.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve</p>	<p>Transparenca është një nga kriteret e punës në UMSH dhe gjithashtu në programet e ndryshme të studimit pra edhe në programin dhe departamentin DMM. Ka disa mënyra se si shpërndahet informacioni mbi kriteret e pranimit të studentëve, së pari në bashkëpunim me QKA promovohet njësi bazë dhe</p>



<p>profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>programi tek shkollat e mesme (aneks 20 broshurë promovuese UMSH). Publikohen kuotat e pranimit kriteret dhe programet e studimit në portalin U-Albania.</p> <p>Informacioni mbi përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimet dhe njoja e studimeve të mëparshme është i aksesueshëm për studentët e interesuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit, por edhe përmes marrjes së shërbimit dhe dokumentacionit nga stafet mbështetëse administrative, sekretaritë etj. Në rregulloret e UMSH, dhe të FSHE janë të qarta kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, kriteret e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme dhe vlerësimi i dijeve.</p> <p>Publikimi i informacionit për sa më sipër në Web-site e UMSH dhe gjithashtu në faqet sipas departamenteve për programet e studimit, është garanti themelor për aksesueshmërinë nga publiku. Por edhe mjetet moderne të marketingut si mediat sociale të UMSH dhe Këshillit Studentor përdoren informimin e publikut dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UMSH harton dhe publikon kriteret për pranimin në program, ku përfshihen, si për gjithë programet, edhe për këtë program kritere të veçanta si dhe kuotat për studentët me aftësi apo kushte të vërcata, kjo në zbatim të rregullave dhe legjislacionit përkatës.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 22: Rregullore për studentët me aftësi ndryshe</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Politikat e bursave/ndihmës janë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së UMSH në lidhje me mbështetjen e studentëve. Prandaj dhe institucioni ka diversifikuar tipet e bursave që mund të ofrojë për ndjekjen e programeve të ndryshme të studimit. UMSH është kujdesur të ofrojë bursa jo vetëm për studentët ekselentë, por edhe për student nga kategori të marginalizuara dhe shtresa në nevojë. Vendimet për masën dhe tipin e bursave merren çdo vit përpara fillimit të vitit akademik, duke u bazuar edhe në kërkesat e studentëve përmes formularëve të regjistrimit. Kategoritë e bursave që ofrohen nga UMSH janë bursat sociale, ato të ekselencës, të sportit dhe bursat</p>

	mbështetëse. <i>Evidenca 2: Plani strategjik i zhvillimit i UMSH</i> <i>Evidenca 3: Strategjia e zhvillimit te programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 22: Rregullore për studentët me aftësi ndryshe</i>			
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht duke qenë se institucioni përmbush gjithë kornizën ligjore në fuqi, si dhe ka ndërtuar rregullore dhe procedura për të zbatuar këtë kornizë, lidhur me pranimin e studentëve, mbështetjen e tyre në procesin e shkollimit, mundësitë që u jep lidhur me mbështetjen financiare si dhe kriteret e tjera të sipërpërmendura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Në statutin e UMSH, në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e FSHE paraqiten të gjitha procedurat se si studentët përparojnë gjatë programit, në lidhje me kurset, kreditet, kalimin nga një vit në tjetrin, diplomimin.</p> <p>Kohëzgjatja e studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe ecuria e studimeve janë elemente të parashikuara në rregulloret e FSHE dhe rregulloren e studimeve MMT. Aksesimi nga publiku garantohet nga publikimi i rregulloreve në Web-site e UMSH. Procedurat e përparimit akademik lidhen me procesin e mësimdhënies, si edhe përgjatë semestrave dhe vitit akademik. Çdo pedagog vendos në dispozicion syllabusin, me informacion mbi kreditet, synimet, temat, mënyrën e vlerësimit dhe këto shërbejnë për informimin e studentit se si do të mund të përparojë gjatë studimeve në çdo modul.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023 numri i studentëve është 30 dhe për vitin akademik 2023-2024 ky numër është 44 studentë.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i></p>

	<p>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT Evidenca 32: Udhëzues për studentët</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Rregulloret gjithashtu përmbajnë nenet përkatëse për të informuar studentët në rastet e transferimeve për procedurat e njohjes së provimeve të mëparshme bazuar mbi programet si edhe njohjen e lëndëve dhe provimeve nga komisionet ad-hoc të ngritura për këtë qëllim.</p> <p>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Takimet informuese me studentët e kursit të parë nga stafi akademik përbëjnë edhe një element shtesë për informimin mbi modulet, procedurat dhe mënyrat e përparimit të studentëve përgjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p>Përveç stafit akademik në secilën prej lëndëve dhe nëpërmjet syllabuseve të shkruara, dhe sekretaritë mësimore dhe administrate në funksion të departamenteve janë në dispozicion të studentëve të interesuar për të marrë më tepër informacion për çdo çështje me interes përgjatë periudhës së studimeve.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT Evidenca 11: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të studentëve janë të mirëpërcaktuara dhe të shpallura në faqen e Internetit përmes Statutit dhe rregulloreve përkatëse.</p> <p>Informimi i studentëve gjithashtu ndodh në takimet e sipërpërmendura informuese në çdo fillim viti akademik.</p> <p>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT Evidenca 36: DPMMT Program orientues për provim formimi_2023-2024</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi</p>	<p>Njësitë bazë dhe ZKSK ofrojnë informacion të bollshëm për programet e studimit. Gjithashtu fushata të informimit të studentëve si edhe faqja e Internetit janë dy mjete kryesore për udhëzimin dhe informimin e të interesuarve për të studiuar pranë UMSH si dhe në programin e studimit. Shumë prej studentëve dhe gjatë vizitën në institucion në takimin me studentët pranuan se janë informuar përmes mediave elektronike, faqes së Internetit dhe platformave të aplikimit online për programin e studimit. Gjithashtu institucioni ka edhe</p>


programin e studimit	një broshurë të programeve akademike që mund të ndjekë student. <i>Evidenca 48: Broshura e programeve</i>			
Konkluzione	<i>Informimi i studentëve mbi rrugën e tyre të përparimit akademik është i garantuar përmes rregulloreve të institucionit në të gjitha nivelet dhe në programin e studimit si dhe mjetet e informimit përdoren në mënyrën e duhur për të krijuar lidhjen me studentët dhe komunitetin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit është e parashikuar në rregulloren e FSHE dhe rregulloren e programit të studimit. Informimit përmes rregulloreve mbështet në mënyrë aktive nga informacion që u jepet studentëve nëpërmjet takimeve me pedagogët e programit, nga zyra e ZKSK, nga koordinatori i programit si dhe nëpërmjet web-site dhe mediave sociale apo edhe broshurave të publikuara për qëllim informimi mbi strukturën e programit dhe lëndët/modulet si dhe për promovimin e programit. <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres <i>Evidenca 48: Broshura e programeve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rregullorja e programit të studimit jep informacionin e nevojshëm për lëndët, modulet e programit të studimit. Mënyra se si institucioni informon studentët mbi programet e studimit dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese është përmes: <ul style="list-style-type: none"> • Botimit të kurrikulës së detajuar me informacion për lëndët/modulet, kreditet, përmbajtjen dhe kategorizimin e veprimtarive në Web - site

	<ul style="list-style-type: none"> • Botimit të Broshurës së programeve ku gjendet informacion • Prezantimit me informacionin që në fillim të regjistrimit të studentëve në UMSH dhe në takimet e para informuese • Sekretarive dhe ZSKS si edhe personelit në departament <p>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT Evidenca 48: Broshura e programeve</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/65188528b779f.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Elementi primar që i shërben institucionit dhe specifikisht departamentit për të promovuar studentët në tregun e punës është praktika profesionale. Në këtë diplomë mbështen studentët në procesin e praktikës duke sygjieruar dhe garantuar marrëveshje me kompani/organizata/administrate. Kjo i ndihmon ata për të bërë një prezantim të mirë fillestar në tregun e punës.</p> <p>Koordinimi me Zyrën e Zhvillimit të Karrierës është gjithashtu proces përmes së cilit DMM mbështet studentët në përballjen me tregun e punës. Ky proces bashkëpunimi ka rezultuar efikas (intervistat me studentët) në aspektin e këshillimit për ndërtimin e CV, aplikimit për punë, letrës së motivimit, kërkimit të informacionit për punë, etj.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/458/praktikat-profesionale-studentet-e-umsh-vizitojne-operatoret-turistike</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, gjendet dhe vendoset në mënyrë të dukshme në të gjitha hapësirat fizike.</p> <p>Informacioni mbi orarin dhe sallat është i afishuar në stenda, dhe në faqen e Internetit. Sinjalistika shërben për të orientuar studentët në mënyrën e duhur për shfrytëzimin e mjediseve, infrastrukturës dhe shërbimeve.</p> <p>Evidenca 48: Broshura e programeve Evidenca 50: Kalendari Akademik 2023-2024</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në bashkëpunim me DMM që është edhe departamenti përgjegjës për programin DPMMT, mbështet studentët jo vetëm me informacion dhe komunikime, por edhe duke organizuar aktivitete të ndryshme</p>



<p>të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>me bizneset, me lektorë të ftuar dhe me institucione për tu hapur atyre rrugën dhe kontaktet për tregun e punës. Gjithashtu nga vizita në Institucion u vu re se në këtë diplomë profesionale ka edhe një numër studentësh që kanë përvoja në tregun e punës në Turizëm dhe prandaj edhe po ndjekin një kualifikim shtesë. Këto përvoja i kanë ndihmuar edhe në rrjetin e tyre që të orientohen më mirë në treg.</p> <p>Sipas edhe takimit me Zyrën e Karrierës gjatë vizitës në institucion, u tha se bëhen dy takime ne muaj me keshillin studentor duke marre parasysh keshillimin e karrieres, si një pjesë em rëndësi dhe interes për studentët.</p> <p>Evidenca 48: Broshura e programeve Evidenca shtesë: Permbledhje e aktiviteteve per turizmin ne UMSH 2024 Evidenca: Vizita në Institucion https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni realizon informim të plotë studentëve për programin, modulet, procesin e edukimit dhe diplomimin. UMSH organizon edhe aktivitete të veçanta për informimin dhe komunikimin me studentët përveç përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe akteve rregullatore të brendshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo</p>	<p>UMSH përmes Zyrës së Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me ZSKS grumbullon dhe përpunon të dhënat lidhur me regjistrimet/aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me moshën, shpërndarjen gjeografike, trajtimin me bursa, numrin e të diplomuarve, etj</p> <p>Institucioni përmes zyrave të mësipërme gjithashtu mban informacion për të gjithë studentët që janë larguar nga</p>

<p>mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>programi përpara përfundimit apo për mospërfundimin me sukses të programit. Evidentimi për këtë fakt u bë në ZSS në regjistrat, duke marrë një kampionim për programin e studimit dhe për të parë standartet e ruajtjes së informacionit. Gjithashtu evidence tregojnë edhe dokumentat e mëposhtëm.</p> <p><i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 8: Përmbledhëse e Tabelave për Programin e studimit DPMMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore menaxhohen përmes sistemit elektronik të shpjeguar më lart dhe ZSKS, duke u ruajtur në regjistra së bashku me vlerësimet dhe arritjet akademike. Të dhënat e studentëve ruhen në sistemin e menaxhimit të informacionit përmes skedave të tyre Log-in, në mënyrë që ata të garantojnë marrjen e rezultateve përmes sistemit.</p> <p>Përmes rregullores së FSHE garantohet ruajtja dhe konfidencialiteti i të dhënave individuale.</p> <p><i>Evidenca 24: Manual i përdorimit të platformave elektronike</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>ZSKS, pra është përgjegjëse për menaxhimin e dokumentacionit në mënyrë që të ketë mundësi të vlerësojë gjendjen aktuale dhe saktësinë e informacionit të studentëve dhe vlerësimeve të tyre të arritjeve akademike.</p> <p>UMSH gjithashtu mbështetet mbi të gjitha rregulloret dhe kontrollon e zbatimit të tyre, nëpërmjet analizave periodike si dhe mbi kodin e etikës për të garantuar mbarëvajtjen lidhur me dokumentacionin dhe veprimtarinë përkatëse të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i> <i>Evidenca 11: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut</i> <i>Evidenca 44: Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>DMM harton raporte analitike të përvitshme të punës së departamentit, duke përfshirë në raport edhe të dhënat lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, duke përfshirë informacion si notat mesatare, kuotat e regjistrimit dhe numri aktual i të regjistruarve, numri i studentëve të larguar, etj., duke bërë dhe analizat përkatëse dhe sygjeruar veprime për të ardhmen bazuar mbi këto statistika.</p> <p><i>Evidenca 8: Përmbledhëse e Tabelave për Programin e studimit</i></p>

përmirësimin të këtyre treguesve.	DPMMT			
Konkluzione	Të dhënat dhe statistikat vjetore të studentëve ruhen në mënyrën e duhur si edhe përpunohen nga institucioni, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, por sidomos duke siguruar mundësi për analiza më të thelluara të cilat do t'i nevojiten vendimmarrjes. Këto përpunime dhe analiza që tashmë bëhen, vihen në përdorim sa më efektiv për vendimmarrje lidhur me programin e studimit në fjalë MMT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese sipas ligjit 80/2015, bazuar në nenin 54 dhe 55 të tij si dhe mbështetje të Statutit të UMSH. Studentët organizaohen në këshilla studentore në nivel fakulteti dhe UMSH. Këshillat e studentëve janë organizata të pavarura të cilat nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike apo politike, por sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në procesin zgjedhor dhe koordinojnë pjesëmarrjen me përfaqësim në organet drejtuese, sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015. Studentët përfshihen gjithashtu edhe në veprimtari të tjera lidhur me institucionin, psh., në ZSKS, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm të këshillit të studentëve, zakonisht duke ndihmuar dhe mbështetur në procesin e vlerësimit dhe në shpërndarjen e mundësive për zhvillimin e karrierës, përmes takimeve zakonisht dy herë në muaj.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	E drejta e studentëve për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në mënyrë që të përfaqësohen në organet drejtuese dhe komisionet e përhershme garantohet nga statuti i UMSH. Nga ana tjetër studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit të punës së programit dhe pedagogëve përkatës, kjo përmes formularit të

<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>anketimit të studentëve. Ky proces u jep atyre një fuqi reale për të ndikuar në proceset e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>UMSH siguron gjithashtu mbështetje për veprimtaritë e studentëve jashtë kurrikulës, që mund të jenë veprimtari muzikore, sportive, bamirësie etj.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 38: Rregullore e ZKSK</i> <i>Evidenca 27: Procedura e punës me fokus grupet</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>DMM ka në rregulloren e tij nenin që pasqyron mbajtjen parasysh të ngarkesës akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p><i>Evidenca 27: Procedura e punës me fokus grupet</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Dy janë momentet ku pasqyrohet marrja parasysh e mendimeve të studentëve për hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve:</p> <p>Përmes plotësimit të anketave, ku një informacion i kërkuar është përmes pyetjes së lidhur me procesin mësimor dhe programet apo informacionin në lidhje me lëndën.</p> <p>Përmes komunikimit në klasë mbi kuptimin e lëndës, tematikës, bashkëveprim në seminare, shqyrtime rste studimit, apo pyetjeve nëse kërkojnë dicka të ndryshme apo tjetër lidhur me metodat dhe procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit DPMMT</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për përfshirjen e studentëve jo vetëm në organiet vendimmarrëse, por edhe nëpërmjet rregulloreve dhe procedurave të zbatuara, edhe në përmirësimin e procesit të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Struktura drejtuese e UMSH e njësisë kryesore dhe e njësisë bazë DMMT, janë në shërbim të vazhdueshëm të studentëve të kësaj dege. Dy fushat që bazohet shërbimi i studentëve janë: mesimdhënia dhe zhvillimi i karrierës.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve dhe informacioneve është funksion dhe symin kryesor i ZKSK. Ajo u ofron studentëve informacion mbi gjithë hallkat e procesit të arsimimit, informacion të dobishëm për mbarëvajtjen e procesit akademik të tyre si edhe informacion në raste transferimesh, midis IAL-ve, informim për studentët në pjesën e fundit të studimeve të tyre, në qasjen me tregun e punës, por edhe lidhur me praktikat dhe kompanitë në treg.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 4: Rregullore e organizimit të UMSH</i> https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>ZKSK ofron informacionin kryesor për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Çështjet për të cilat mund të informohen studentët nga ZKSK më konkretisht janë të lidhura me regjistrimin, plotësimin e diplomave, programet dhe kurrikulat e diplomimit, transferimet nga një fakultet në tjetrin, zhvillimi i procesit mësimor. ZKSK jep gjithashtu edhe shërbime për studentët si suplementin e diplomës, marrjen e vërtetimeve të studentit, programe lëndësh, transferim studimesh, vendim çregjistrimit etj.</p> <p>Sa i përket aspekteve të lidhura strikt me procesin mësimor, stafet akademike në faqet e tyre japin infoarcionin përkatës mbi lëndët apo modulet. Lidhur me vlerësimet ato merren gjithashtu prej sistemit elektronik SMSUMSH.</p> <p><i>Evidenca 38: Rregullore e ZKSK</i></p>

	Evidenca 21: Anëtarët e ZKSK viti akademik 2023-2024			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	ZKSK u shërben studentëve, si zyrë qendrore por e shpërndarë edhe në fakultet dhe departamente, për të mbështetur zhvillimin e karrierës së studentëve. ZKSK në bashkëveprim DMM ofron informacion mbi punësimin e mundshëm, praktikën, internship në bazë të programeve përkatëse. ZKSK ka mbështetur studentët në njohjen më të mirë të procesit të aplikimit për punë dhe dokumentacioneve të nevojshme. Ajo gjithashtu ka krijuar shumë mundësi për punësimin në tregun e përshtatshëm të punës, përmes promovimit dhe marrëveshjeve me kompani dhe organizatat, si dhe me ruajtjen e marrëdhënieve me alumni. Evidenca 38: Rregullore e ZKSK https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Njësia bazë është ajo e DMM dhe në bashkëveprim me ZKSK mbledh dhe përpunon të dhëna për studentët pas diplomimit. Ajo mban kontakt të vazhdueshëm përmes lidhjeve edhe me tregun e punës por edhe me ALUMNI të cilët janë pjesë e industrisë së turizmit. ZKSK merr parasysh dhe mban të dhëna për profilin e studentit dhe punësimin e tyre. Kjo praktikë do ndiqet edhe për studentët që për herë të parë po diplomohen në DPMMT. Evidenca 38: Rregullore e ZKSK https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres			
Konkluzione	<i>Procedurat për orientimin e studentëve gjatë studimeve edhe pas përfundimit të tyre janë të mirëpërcaktuara nëpërmjet ngritjes së zyrave përkatëse si edhe të mirëzbatuara nga departamenti dhe për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Menaxhim dhe Marketing Turizmi”, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime


1. Programi i studimit mbështetet në një staf me përvoja të rëndësishme të bazuara edhe në praktikën e industrisë përveçse në kualifikimet Brenda dhe jashtë vendit, staf i cili është pjesë e departamentit Menaxhimit dhe Marketingut prej një kohe relativisht të qëndrueshme
2. Struktura drejtuese dhe vendimmarrëse si dhe strukturim i departamentit në mënyrë të qëndrueshme ku vihet re dhe një orientim për vazhdimësinë e stafit gjë që e diferencon nga IAL të tjera private në hapësirën e arsimit të Lartë në Shqipëri.
3. Programi mundëson formimin e studentëve me njohuri dhe aftësi të nevojshme në industrinë e turizmit në disa prej sektorëve të saj nëpërmjet njohurive të ofruara nga kurset në tërësi. Mund të theksojmë njohuritë dhe aftësitë digjitale të cilat janë në një nivel të pëlqyeshëm.
4. Program studimi i lidhur me nevojat e tregut dhe i bazuar në vazhdimësinë e numrit të studentëve dhe marrëveshje e bashkëveprim të niveleve të kënaqshme me operatorët turistikë në tregun e punës, kjo edhe falë eksperiencës dhe praktikave të stafit akademik.
5. Promovim dhe komunikim në nivele të larta për programin e studimit në vijimësi të strategjive të mirëndërtuara në tërësi në institucion.
6. Një sistem efikas i menaxhimit të Informacionit nëpërmjet platformave elektronike.

Pika të dobta

1. Pavarësisht një kurrikule të ndërtuar me kujdes dhe në përshtatshmëri me titullin e diplomës dhe kërkesat e tregut, ka disa lëndë apo module që do të bënin diferencë në treg për sa i përket zhvillimeve aktuale dhe të ardhshme në industrinë e turizmit, të lidhura me konceptet e qëndrueshmërisë dhe specifike në marketingun e turizmit. (Standardi II.1, kriteri 5)
2. Një pike e dobët vihet re tek syllabuset sa u përket disa tematikave të mbivendosura në lëndë të ndryshme të cilat mund të diskutohen në vijimësi në takimet midis stafit të programit. (Standardi II.1, kriteri 5).

Rekomandime

1. Rishikim minimal në ndryshimin e lëndëve për më specifike drejtuar industrisë së turizmit, p.sh. tek Turizmi i Qëndrueshëm apo lëndë me zgjedhje.
2. Disa mbivendosje të tematikave në disa prej lëndëve duhen parë për një përmirësim cilësor në vijimësi, për një afat më të gjatë kohor.



Evaluation's conclusions for the professional study program "Management and Marketing of Tourism" provided by the Higher Education Institution "Mediterranean University of Albania"

Strengths and affirmations


1. The study program is supported by an experienced staff based on industry practice as well as appropriate qualifications in Albania and abroad. The teaching staff have been part of the Management and Marketing department for a relatively stable period.
2. The institution is noted for a stable management and decision-making structure. The department's organization and structure has a focus on staff continuity, which makes a difference from other private HEIs in the higher education space in Albania.
3. The program offers the necessary knowledge and skills to students' formation in the whole tourism industry, and especially in some of its main sectors through the knowledge provided by all the courses. The digital knowledge and skills are emphasized at a satisfactory level.
4. A well based program in the market needs and the continuity of student numbers, with an excellent level of interaction and institutional agreements with tourist operators in the labor market, thanks to the experience and practices of the academic staff.
5. High level of promotion and communication for the study program in line with well-established strategies throughout the institution.
6. An efficient information management system through electronic platforms.

Weaknesses

1. Despite a carefully constructed curriculum and in line with the degree title and market requirements, there are some subjects or modules that, if added, would make a difference in the market in terms of current and future developments in the tourism industry, related to the concepts of sustainability and the specifics of tourism marketing. (Standard II.1, criterion 5)
2. A weak point is noted in the syllabus regarding some overlapping topics in different subjects which could be discussed continuously in meetings between the program staff. (Standard II.1, criterion 5).

Recommendation

1. Minimal revision in actual list of courses to few more specific ones aimed at the tourism industry, e.g. Sustainable Tourism or elective courses.
2. Monitor topics overlap in some of the courses for a continuous qualitative improvement, in a longer term.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X